



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.176

26 nëntor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 016 datë 13.11.2008	Për ratifikimin e “Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) e Shtabit të Komandës së Lartë Aleate për Transformimin (HQ SACT), për masat mbështetëse të shtetit pritës, për kryerjen e operacioneve të NATO-s” 8725
Ligj nr.10 018 datë 13.11.2008	Për Avokaturën e Shtetit 8735
Vendim i Kuvendit nr.225, datë 13.11.2008	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 8746
Vendim i KM nr.1306, datë 24.9.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.1203, datë 27.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës së saktë, në përqindje, të rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup minerale” 8749
Udhëzim i MF nr.17/3, datë 13.11.2008	Për disa shtesa në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” 8750
Vendim i GJK nr.14, datë 21.7.2008	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me nenin 148/1 të Kushtetutës, i neneve 24 pikat 2 dhe 5, 323 pika 1, 327 pika 2 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale..... 8751
Vendim i GJK nr.24, datë 12.11.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën 8756

LIGJ
Nr.10 016, datë 13.11.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË
FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE) E SHTABIT TË KOMANDËS SË LARTË
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN (HQ SACT), PËR MASAT MBËSHTETËSE TË SHTETIT
PRITËS, PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE TË NATO-S”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) e Shtabit të Komandës së Lartë Aleate për Transformimin (HQ SACT), për masat mbështetëse të shtetit pritës, për kryerjen e operacioneve të NATO-s”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5949, datë 24.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË DHE SHTABIT TË
KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR TRANSFORMIMIN NË LIDHJE ME MASAT
MBËSHTETËSE TË SHTETIT PRITËS PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE TË NATO-S**

Hyrje

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes (MoD) dhe Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), këtu e tutje të quajtura Palë,

duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, dhe në veçanti nenin 3 të saj;

duke pasur parasysh dokumentin kuadër të Partneritetit për Paqe të lëshuar prej kryetarëve të shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut (dokumenti kuadër) të 10 janarit 1994;

duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes midis shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me statusin e forcave të tyre (PfP SOFA) të datës 19 qershor 1995, përfshirë edhe protokollin shtesë të kësaj Marrëveshjeje të datës 19 qershor 1995;

duke pasur parasysh dispozitat e marrëveshjes ndërmjet palëve pjesëmarrëse në Traktatin e Atlantikut të Veriut në lidhje me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

duke pasur parasysh dispozitat e protokollit mbi statusin e shtabeve ushtarake ndërkombëtare

hartuar në vijim të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

duke pasur parasysh dispozitat e protokollit të mëtejshëm shtesë mbi marrëveshjen midis shteteve anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Pfp SOFA (Protokoll i mëtejshëm shtesë) i datës 19 dhjetor 1997;

duke pasur parasysh konceptin e shpërndarjes së forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën dhe kontrollin e NATO-s në ose përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhave të paqes, krizave, emergjencave dhe konflikteve në mbështetje të operacioneve të udhëhequra nga NATO;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve të parashikuara që të zhvillohen me NATO-n, Pfp dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO;

dhe duke marrë në konsideratë nevojat e Republikës së Shqipërisë, e cila këtu e tutje quhet vendi pritës dhe nevojat e Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), këtu e tutje të referuara individualisht dhe kolektivisht si komanda strategjike,

palët kanë arritur në mirëkuptimin e mëposhtëm.

SEKSIONI 1 PËRKUFIZIME

Për qëllim të këtij memorandumi mirëkuptimi dhe dokumenteve të tij plotësuese aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat. Të gjithë komponentët e forcave të udhëhequra nga NATO, përfshirë këtu edhe të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe ushqimet, bashkë me përbërësit civilë të këtyre forcave, ashtu siç është përcaktuar edhe në NATO SOFA, protokollin e Parisit dhe homologët e Pfp. Forcat e NATO-s përfshijnë gjithashtu çdo forcë (personel, gjë e gjallë, materiale dhe rezerva ushqimore etj.) prej çdo shteti të autorizuar prej Këshillit të Atlantikut Verior të marrë pjesë në stërvitje apo operacion. Përcaktimi gjithashtu përfshin të gjitha anijet, avionët, automjetet, pajisjet, furnizimet, rezervat dhe armatimet, si dhe të gjitha burimet e lëvizjeve detare e ajrore, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, përfshirë dhe kontraktuesit shpërndarës ose mbështetës të forcave.

1.2 Operacionet e NATO-s. Veprimet ushtarake apo misionet ushtarake strategjike, taktike, shërbimi, trajnuese, të zhvilluara nga forcat; procesin e zhvillimit të luftimit, përfshirë sulmin, dislokimin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat e nevojshme për arritjen e objektivave të çdo beteje ose fushate.

1.3 Komandanti i NATO-s. Komandant ushtarak në hallkat komanduese të NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s. Shtabe dhe njësi forcash të organizuara nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Shtabet ushtarake ndërkombëtare. Shtabet ushtarake ndërkombëtare në strukturat përbërëse komanduese të NATO-s. Këtu përfshihen dhe ekipet dhe njësitë e përkohshme të këtyre shtabeve.

1.6 Shtabet kombëtare. Shtabet e forcave kombëtare nën kontrollin dhe komandën e NATO-s.

1.7 Shtabet shumëkombëshe. Shtabe me personel të përbërë nga më shumë se një shtet, të formuara në bazë të marrëveshjes mes shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Vendet dërguese (VD). Ato shtete ose elemente që kanë dërguar forca në territorin e Shqipërisë, për të mbështetur operacionet e NATO-s.

1.9 Vendi pritës (VP). Republika e Shqipërisë.

1.10 Komandantët strategjikë ose komandat. Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë dhe Komanda Supreme Aleate për Transformimin, shtabet e të cilave janë respektivisht SHAPE dhe HQ SACT.

1.11 Mbështetja e vendit pritës (MVP). Asistenca civile dhe ushtarake e dhënë në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti, nga Republika e Shqipërisë për forcat aleate dhe strukturat të cilat janë të vendosura, që operojnë apo janë tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në ujërat territoriale apo hapësirën ajrore.

1.12 Forca mbrojtëse (FM). Të gjitha masat e marra dhe mënyrat e përdorura për të minimizuar cenueshmërinë e personelit, lehtësirat, pajisjet dhe operacionet kundrejt çdo rreziku dhe në

çdo situatë për të mbrojtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcave.

1.13 Shpenzimet. Shpenzimet të cilat lidhen me vendosjen, mbështetjen dhe mbajtjen e shtabeve kombëtare, shumëkombëshe ose shtabet ndërkombëtare, forcat ose organizatat e NATO-s. Për qëllim të këtij memorandum mirëkuptimi dhe dokumenteve që do ta pasojnë:

a) Shpenzimet e përbashkëta të NATO-s. Këto shpenzime të cilat janë pranuar që më parë si përgjegjësi kolektive e aleancës.

b) Shpenzimet e përbashkëta. Për të cilat është rënë dakord më parë të jenë nën përgjegjësinë e përbashkët të më shumë se një kombi. Rregullimet për këto shpenzime zakonisht bazohen në një formulë të detajuar në marrëveshjen teknike përkatëse dhe/ose në rregullimet e përbashkëta të zbatimit.

c) Kostoja kombëtare direkte. Shpenzimet që konsiderohen si përgjegjësi e një vendi dërgues (VD) të vetëm.

1.14 Fondi i përbashkët i NATO-s. Fondi i siguruar nga vendet e NATO-s dhe i livruar me miratim nëpërmjet buxhetit të NATO-s për shpenzimet e përbashkëta, të shkaktuara gjatë zhvillimit të operacioneve ose stërvitjeve përkatëse.

1.15 Notë pjesëmarrjeje (NP). Dokumenti që tregon qëllimin e (VD) për të marrë pjesë në përgatitjet mbi mbështetjen e vendit pritës sipas dispozitave të këtij memorandum mirëkuptimi për një operacion të specifikuar të udhëhequr nga NATO.

1.16 Deklaratë qëllimi (DQ). Dokumenti që shpreh qëllimin e VD-së për të marrë pjesë në përgatitjet mbi mbështetjen e vendit pritës sipas dispozitave të këtij memorandum mirëkuptimi, por i kushtëzuar nga kufizime specifike. Vendi pritës do të konfirmojë nëse kufizimet janë të pranueshme apo jo për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës.

1.17 Marrëveshja teknike (MT). Marrëveshje teknike dypalëshe që ndiqet për një operacion specifik të NATO-s. Detajon përgjegjësitë dhe procedurat për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës nga Republika e Shqipërisë kundrejt komandantit të NATO-s dhe vendit/ve dërguese.

1.18 Marrëveshja e përbashkët e zbatimit. Marrëveshja bilaterale që ndiqet, e cila përcakton angazhimet mes palëve në lidhje me sigurimin dhe marrjen e mbështetjes së vendit pritës. Marrëveshja përfshin informacion të detajuar mbi ndihmën e kërkuar dhe të ofruar, përcakton procedura specifike mbi vendndodhjen e zbatimit dhe afatet e rimbursimit ose pagimit.

1.19 Komiteti Drejtues i Përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës. Komiteti i posaçëm i ngritur për këtë rast dhe i bashkëkryesuar nga Republika e Shqipërisë dhe komandanti i NATO-s. Komiteti i përbërë nga përfaqësues të autorizuar nga të gjitha vendet dërguese, Republika e Shqipërisë dhe komandanti i NATO-s do të mblidhen për të koordinuar përgatitjet zgjeruese të nevojshme që kanë të bëjnë me mbështetjen e vendit pritës, siç janë marrëveshja teknike dhe marrëveshjet e përbashkëta të zbatimit, sipas rastit.

1.20 Vendqëndrimet operationale. Vendqëndrime të lokalizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim mbështetjen operationale dhe/ose logjistike për forcat në operacionet e drejtuara nga NATO. Këto vendqëndrime janë detashmente të Komandës Strategjike nën komandën dhe kontrollin e komandantit të NATO-s.

1.21 Me përjashtim të rasteve kur kuptimi specifikohet në këtë memorandum mirëkuptimi, aplikohet fjalori i termave dhe përkufizimeve të NATO-s (AAP-6).

SEKSIONI 2 QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij memorandum mirëkuptimi është të përcaktojë politikat dhe procedurat për krijimin e vendqëndrimeve operationale dhe sigurimin e mbështetjes së vendit pritës ndaj forcave të NATO-s ose mbështetjen nga Republika e Shqipërisë gjatë operacioneve të NATO-s.

2.2 Kjo Marrëveshje mirëkuptimi dhe dokumentet që dalin prej saj kanë për qëllim krijimin e një baze planifikimi për autoritetin e duhur të Republikës së Shqipërisë dhe komandantin e NATO-s, në pritje të përgatitjeve për mbështetjen e vendit pritës gjatë operacioneve të ndryshme të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat dislokimi i forcave është përcaktuar, si dhe ato për të cilat

pritet të përcaktohen.

SEKSIONI 3 SHTRIRJA DHE ANGAZHIMET E PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO/PfP SOFA, protokollit të Parisit dhe protokollit shtesë dhe çdo marrëveshje tjetër në fuqi midis komandave strategjike të NATO-s dhe Republikës së Shqipërisë do të aplikohen në të gjitha operacionet e NATO-s.

3.2 Republika e Shqipërisë njeh vendqëndrimet operacionale të krijuara për zbatimin e këtij memorandum si detashmente të komandës strategjike dhe veprimtaritë e këtyre detashmenteve të jenë sipërmarrje të komandës strategjike. Vendqëndrimet që do të krijohen do të përcaktohen në dokumentet vijuese. Komanda dhe kontrolli i përgatitjeve do të vendosen në planet e zbatueshme operacionale.

3.3 Ky memorandum mirëkuptimi do të jetë në përputhje me politikën dhe doktrinën e NATO-s dhe siguron një strukturë dhe përgatitje gjithëpërfshirëse për (MVP) mbështetjen e vendit pritës.

3.4 Republika e Shqipërisë do t'u sigurojë mbështetje me kapacitetin e saj të plotë forcave të dislokuara për operacionet e udhëhequra nga NATO në varësi të disponueshmërisë dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave ekzistuese të atëhershme. Detajet e kësaj mbështetjeje do të përcaktohen në dokumentet pasuese.

3.5 Dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi aplikohen në kohë paqeje, emergjencash, krize dhe konflikti ose në periudha tensionesh ndërkombëtare, siç mund të përcaktohen bashkërisht nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë dhe NATO-s.

3.6 Ndërsa vendet dërguese nxiten të marrin pjesë në operacionet e udhëhequra nga NATO dhe të pranojnë dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi si një dokument gjithëpërfshirës nën të cilin Republika e Shqipërisë siguron mbështetjen e vendit pritës, marrëveshje të veçanta bilaterale me shtete individuale mund të merren parasysh nga Republika e Shqipërisë rast pas rasti.

3.7 Republika e Shqipërisë dhe komanda strategjike mund të përcaktojnë përfaqësues për të diskutuar në lidhje me dokumentacionin rezultues që mbështet dhe plotëson këtë memorandum mirëkuptimi.

3.8 Operacionet e udhëhequra nga NATO, të mbështetura nga ky memorandum mirëkuptimi mund të kërkojnë mbështetje shumëkombëshe për operacionet ajrore përmes avionëve dhe helikopterëve me krahë të fiksuar dhe në rastin e porteve, përmes mjeteve lundruese mbështetëse ushtarake e tregtare. Republika e Shqipërisë pranon se lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhave në dhe përgjatë territorit të Republikës së Shqipërisë do të realizohet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e operacionit. Republika e Shqipërisë do të kontrollojë/administrojë të gjitha aspektet e kësaj lejeje.

3.9 Ky memorandum mirëkuptimi ka për qëllim të jetë në harmoni me ligjet e vendit pritës dhe me çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare të zbatueshme.

SEKSIONI 4 DOKUMENTE REFERENCE

4.1 Dokumentet e referueshme që mund të zbatohen në këtë memorandum mirëkuptimi janë në përmbajtje të shtojcës A.

SEKSIONI 5 PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij memorandum mirëkuptimi

5.1 Vendi pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse të këtij memorandum mirëkuptimi dhe sipas

ndryshimeve që do të ndodhin, dhe pas plotësimit të këtyre dokumenteve, Republika e Shqipërisë do ta njoftojë në kohë komandën përkatëse të NATO-s, lidhur me disponueshmërinë dhe ndonjë mangësi në kapacitetet e mbështetjes të vendit pritës. Republika e Shqipërisë duhet të ketë parasysh se projektet e NATO-s mbështeten në dokumentet e krijuara mbështetëse të kësaj marrëveshjeje dhe kërkojnë njoftim në kohë për ndryshime të planifikuara në lidhje me krijimin dhe kapacitetin kombëtar.

b) Në mënyrë që të sigurohet mbështetja, Republika e Shqipërisë do të realizojë përgatitjet e nevojshme me burime mbështetëse, përfshirë burime civile dhe tregtare. Mbështetja tregtare do të sigurohet nëpërmjet një procesi ofertash konkurruese prej ofertës më të ulët.

c) Republika e Shqipërisë do të mbajë të dhënat administrative e financiare të nevojshme për rimbursimin e Republikës së Shqipërisë për burimet e siguruar ndaj forcave. Të dhënat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxhetet e NATO-s do t'i jepen NATO-s, kur të kërkojnë për qëllim auditimi.

d) Standardi i mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga Republika e Shqipërisë do të jetë në përputhje me detajet e përcaktuara në dokumentet shtesë mbështetëse.

e) Republika e Shqipërisë do të ruajë kontrollin e burimeve të tij mbështetëse, përveç rasteve kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) Republika e Shqipërisë do të sigurojë përpara çdo operacioni të udhëhequr nga NATO, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar prej tij.

g) Republika e Shqipërisë do të ftojë vendet dërguese të pranojnë dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi ose me anë të një note pjesëmarrjeje ose deklaratë qëllimi.

h) Republika e Shqipërisë do të sigurojë procedurat për një lidhje mjekësore midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve dërguese, përfshirë pikat e kontaktit mjekësor.

i) Republika e Shqipërisë (në koordinim me komandën e NATO-s) do t'u sigurojë forcave, mbështetje mjekësore dhe dentare nëpërmjet personelit/shërbimeve ushtarake në të njëjtat kushte sikundër personelit ushtarak të Republikës së Shqipërisë.

j) Gjatë realizimit të mbështetjes dhe dokumentacionit pasues, Republika e Shqipërisë do të sigurojë për komandantin e NATO-s kopje të çdo rregulloreje që ka të bëjë me bujqësinë, shëndetësinë, shëndetin dhe sigurinë, të cilat mund të aplikohen në operacionin e udhëhequr nga NATO, si dhe rregulloret që kanë të bëjnë me ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

k) Çdo kërkesë për mbështetje shtesë të paparashikuar nga ky memorandum mirëkuptimi do të diskutohet ndërmjet Palëve ose ndërmjet vendit pritës dhe vendeve dërguese, me synim zgjidhjen e vështirësive të ndryshme dhe atyre logjistike nëpërmjet bërjes së marrëveshjes shtesë për mbështetjen e vendit pritës.

5.2. Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s do të sigurojë në maksimumin e mundshëm që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, masën dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Është vërejtur se misioni dhe struktura e forcave nuk mund të specifikohen para hartimit të planit të operacionit (OPLAN). Mandatit operacional (OPORD) ose rendit operacional të stërvitjes. Komanda NATO-s do të sigurojë informacion shtesë të nevojshëm për planifikimin nga ana e vendit pritës sa më shpejt që të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s do të njoftojë në kohë Republikën e Shqipërisë për çdo ndryshim sipas rrethanave dhe do të propozojë modifikime të dokumenteve rezultuese, sipas nevojës.

c) Komandanti i NATO-s do të përcaktojë nëse financimi i përbashkët është i disponueshëm dhe se cilat kërkesa janë të pranueshme për një financim të tillë.

d) Komandanti i NATO-s do të përcaktojë dhe vendosë prioritetet mbi mbështetjen e vendit pritës dhe do të miratojë kuotat e pagesave të përbashkëta.

e) Komandanti i NATO-s do të sigurojë rimbursime financiare për Republikën e Shqipërisë për mbështetjen e vendit pritës të rënë dakord, nëse parashikohet të paguhet nëpërmjet fondit të përbashkët. Në të gjitha rastet e tjera, komandanti i NATO-s do të ndihmojë sa të jetë e mundur në zgjidhjen e detyrimeve financiare midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve dërguese.

f) Nëse kërkesat e vendeve dërguese nuk përputhen me prioritetet e shpërndarjes së burimeve të komandës së NATO-s, komanda përkatëse e NATO-s do ta zgjidhë konfliktin me vendet dërguese të përfshira.

g) Komandanti i NATO-s do të identifikojë personelin dhe kërkesat e tjera për vendqëndrimin

operacional që do të ngrihet në Republikën e Shqipërisë.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe pagesave për mbështetje gjatë negociatave dhe/ose në Komitetin Drejtues të Përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës.

5.3 Vendet dërguese

a) Vendet dërguese mund të zgjedhin për të marrë pjesë në procedurat dhe strukturat për mbështetjen e vendit pritës, duke pranuar dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi nëpërmjet një note pjesëmarrjeje dhe ose deklaratës së qëllimit për operacionin e detajuar të NATO-s.

b) Vendet dërguese do të identifikojnë kërkesat e mbështetjes së vendit pritës të Republika e Shqipërisë dhe komandanti përgjegjës i NATO-s.

c) Për kërkesat e kostos së drejtpërdrejtë kombëtare, vendet dërguese do të marrin pjesë në negociatën për mbështetjen e vendit pritës gjatë takimit të Komitetit Drejtues të Përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës ose direkt me Republikën e Shqipërisë, nëse Komiteti Drejtues i Përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës nuk është krijuar ende. Vendet dërguese do të sigurojnë pagesë direkte ose rimbursojnë mbështetjen e vendit pritës të Republika e Shqipërisë vetëm për shërbimet e siguruar nga burime ushtarake, me përjashtim të rasteve kur procedura të tjera përdoren siç është rënë dakord. Sipas marrëveshjeve kontraktuale të bëra ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve dërguese, mbështetja e siguruar nga burimet private ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga vendet dërguese.

d) Vendet dërguese do të sigurojnë një personel të autorizuar për të marrë pjesë në negociatat me vendin pritës në Komitetin Drejtues të Përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës, nëse ekziston.

e) Vendet dërguese do të raportojnë ndryshimet në kërkesat e mbështetjes së vendit pritës të Republika e Shqipërisë dhe komandanti përkatës i NATO-s, kur ato ndodhin dhe paraqesin kërkesat e rishikuara dhe/ose raportet për statusin.

f) Vendet dërguese janë përgjegjëse për koston e çdo shërbimi mjekësor dhe dentar civil të siguruar nga Republika e Shqipërisë.

g) Vendet dërguese duhet të ndjekin rregulloret dhe procedurat mbi bujqësinë, ambientin, sigurinë dhe shëndetin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara për vendqëndrimet operationale, si dhe çdo rregullorë të vendit pritës mbi ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI 6 DISPOZITAT FINANCIARE

6.1 Protokollin e Parisit, protokollin e mëtejshëm shtesë dhe ligji ndërkombëtar zakonor, i cili zbaton imunitete dhe privilegje për shtabet aleate të NATO-s do të aplikohet për çdo shtab ndërkombëtar, elementet ose detashmentet e të cilëve mund të dislokohen në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e operacionit të udhëhequr nga NATO.

6.2 Në bazë të marrëveshjeve dhe/ose konventave ndërkombëtare të ndërsjella, aktivitetet e Shtabeve Ndërkombëtare, vendqëndrimet operationale, mjetet në pronësi dhe/ose në zotërim nga NATO, avionët, automjetet dhe POL, të cilat u sigurohen forcave të NATO-s, do të përjashtohen nga të gjitha taksat, detyrimet, tarifat e shtetit dhe detyrimet e tjera të ngjashme me to.

6.3 Atëherë kur nuk është i mundur përjashtimi i plotë nga taksat, detyrimet, tarifat dhe detyrime të tjera, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Të gjitha shpenzimet duhet të kryhen me vlerën më të ulët të kërkesave administrative shoqëruese.

6.4 Marrëveshjet përfundimtare financiare, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me fondin e përbashkët të NATO-s, mundësisht do të përcaktohen vetëm para zbatimit të një operacioni të NATO-s. Megjithatë, të gjitha marrëveshjet financiare të negociuara dhe bëra paraprakisht, duhet të bëhen specifike sipas detyrimeve financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet e paspecifikuara si shpenzime nga buxheti i NATO-s, para se të shkarkohen, nuk do të përfshihen në fondin e përbashkët të NATO-s.

6.5 Transaksionet financiare, në mënyrë që të përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive bankare në çdo bankë private ose shtetërore, duhet të zhvillohen të përjashtuara nga detyrimet dhe tarifat e çdo lloji.

6.6 Dokumentet pasuese do të sigurojnë bazën fillestare për vlerësimet e kostos dhe do të shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve ose si shpenzime të përbashkëta të NATO-s (nëse është e zbatueshme), shpenzime të përbashkëta ose shpenzime kombëtare të drejtpërdrejta.

6.7 Nëse komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime të caktuara janë si të pranueshme, ashtu edhe të përballueshme për fondin e përbashkët të NATO-s (nga akordimet e miratuara të buxhetit), Komanda Strategjike do të autorizojë financimin e përbashkët për ato shpenzime dhe ose do t'i paguajë drejtpërsëdrejti ose të rimbursojë Republikën e Shqipërisë.

6.8 Nëse disa shpenzime janë parashikuar t'i atribuohen më shumë se një vendi, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të përbashkëta dhe me marrëveshje të përbashkëta me vendet e përfshira, mund të ndahen në përputhje me një formulë për ndarjen e shpenzimeve të miratuara në marrëveshjen teknike ose në dokumente të tjera mbështetëse.

6.9 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të siguruar nga Republika e Shqipërisë nuk do të shlyhen në një shkallë më të lartë se shlyerja për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe nuk do të përfshijnë shpenzime shtesë administrative ose shpenzime të tepërta, por mund të reflektojnë rregullime për shkak të programit të shpërndarjes, pikave të shpërndarjes ose elementeve të ngjashme. Rimbursimi nuk do të paguhet për mbështetjen e siguruar nga personeli ushtarak.

6.10 Komandimi i NATO-s dhe vendet dërguese mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me ofertues tregtarë për oferta, shërbime dhe nevoja të tjera.

6.11 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të vendeve dërguese janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të veprojnë pa siguracion tregtar.

6.12 Republika e Shqipërisë nuk do të shkaktojë ndonjë përgjegjësi financiare në emër të komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese, përveç rasteve kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë më përpara nga një përfaqësues i autorizuar dhe në rastet kur është pranuar përgjegjësia për pagimin e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk do të livrohet derisa Komanda Strategjike ose vendet dërguese, sipas nevojës, të miratojnë dokumentet mbështetëse përkatëse dhe të drejtojnë zbatimin e tyre.

6.13 Financimi nuk jepet në lidhje me këtë memorandum mirëkuptimi dhe ky dokument nuk përfaqëson një detyrim specifik financimi nga ana e komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese. Marrëveshje të veçanta financiare dhe procedura rimbursimi do të specifikohen në dokumentet pasuese.

6.14 Vendosja e zonave operationale për të mbështetur një operation të NATO-s nuk parashikon ndërtimin ose rehabilitimin e infrastrukturës.

SEKSIONI 7 DISPOZITA LIGJORE

7.1 Komanda strategjike do të ekzekutojë ose mund të delegojë masa ligjore thelbësore për realizimin e misioneve, përfshirë këtu, por jo kufizuar me ushtrimin e së drejtës për të kontraktuar për t'u përfshirë në procese ligjore ose administrative dhe për të përfituar e shfrytëzuar pasuri.

7.2 Statusi i forcave të dislokuara në territorin e Republikës së Shqipërisë do të përcaktohet në përputhje me NATO/PfP, SOFA, protokollin e Parisit dhe/ose protokollin e mëtejshëm shtesë, si të jetë e zbatueshme.

7.3 Pajisjet, furnizimet, prodhimet dhe materialet e importuara përkohësisht dhe të eksportuara nga territori i vendit pritës në lidhje me stërvitjen, përjashtohen nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifat. Procedura të tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me NATO-n ose PfP SOFA, protokollin e Parisit dhe protokollin e mëtejshëm shtesë, si të jetë e zbatueshme.

7.4 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin nga, ose në lidhje me zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e NATO/PfP SOFA.

7.5 Pretendimet kontraktuale do të shqyrtohen dhe zgjidhen nga Republika e Shqipërisë përmes procesit që drejton kontratat publike dhe në përputhje me ligjet e vendit pritës, me rimbursim nga komandantit i NATO-s ose vendet dërguese, si të jetë e zbatueshme.

7.6 Anëtarët e Forcës do të kenë me vete këto dokumente kur hyjnë ose kalojnë kufijtë e vendit pritës dhe do t'i paraqesin ato kur iu kërkohen:

- Karta ushtarake e identitetit kombëtar ose e NATO-s.
- Urdhri i udhëtimit i NATO/PfP ose dokumenti kombëtar i udhëtimit.

Vendi pritës do t'i pranojë këto dokumente si dokumente të rregullta për hyrjen në pikat e kalimit kufitar nga anëtarët e Forcës, pa ndonjë kërkesë shtesë, me përjashtim kur specifikohet në dokumentet ose marrëveshjet pasuese.

SEKSIONI 8 MBROJTJA E FORCËS

8.1 Një mbrojtje e plotë dhe efektive e Forcës do të planifikohet për shtabet statike të NATO-s dhe operacionet e NATO-s, trajnimet dhe stërvitjet dhe do të detajohet në OPLANS, EXPI ose marrëveshjet shtesë, sipas nevojës. Mbrojtja e Forcës do të zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në mënyrë të pajtueshme me NATO/PfP, SOFA. Mbrojtja e Forcës në asnjë mënyrë nuk do të kërkohej ose sigurohet në kundërshtim me dispozitat e NATO/PfP SOFA ose ligjet e vendit pritës.

8.2 Republika e Shqipërisë do të informojë vendin dërgues dhe komandantin e NATO-s, sipas nevojës, për masat dhe kufizimet e propozuara të mbrojtjes së Forcës.

8.3 Secili vend dërgues është përgjegjës për identifikimin dhe sigurimin e kërkesave dhe kufizimeve të mbrojtjes së Forcës, sipas rastit, të Republika e Shqipërisë dhe komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç përgjegjësive të mbrojtjes së Forcës, të përcaktuara në politikën dhe procedurat e NATO-s, komandanti i NATO-s është përgjegjës për koordinimin e mbrojtjes së Forcës së kërkuar dhe të siguruar nga vendi pritës dhe vendet dërguese, sipas nevojës, për Forcën.

SEKSIONI 9 SIGURIA DHE ZBULIMI I INFORMACIONIT

9.1 Pjesëmarrësit dhe vendet dërguese do t'i konfirmojnë NATO-s procedurat ekzistente të sigurisë, përdorimin, transmetimin dhe ruajtjen e të gjithë informacionit të klasifikuar që mbahet, përdoret, krijohet, sigurohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i siguruar një tjetri nga ana e një pjesëmarrësi ose vendi dërgues në konfidencë dhe një informacioni të tillë të siguruar nga çdo pjesëmarrës ose vend dërgues që kërkon fshehtësi, ose do të mbajë klasifikimin e tij fillestar, ose do t'i caktohet një nivel klasifikimi, që do të sigurojë një shkallë mbrojtjeje kundër zbulimit, të njëjtë me atë që kërkohej nga pjesëmarrësi tjetër ose vendi dërgues.

9.3 Secili pjesëmarrës dhe vend dërgues do të ndërmarrë hapa ligjorë të disponueshëm për të mbrojtur nga zbulimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në konfidencë, përveçse kur pjesëmarrësit e tjerë dhe/ose vendet dërguese e miratojnë një zbulim të tillë.

9.4 Për të ndihmuar në sigurimin e mbrojtjes së kërkuar, secili pjesëmarrës ose vend dërgues do të shënojë informacionin e dhënë tjetrit në konfidencë me një legjendë që tregon origjinën e tij, klasifikimin e sigurisë, kushtet e publikimit që ky informacion, ka lidhje me një operacion specifik të NATO-s dhe se ai është siguruar në konfidencë.

9.5 Vizita nga ana e personelit do të kryhet në përputhje me procedurat e specifikuara në C-M (2002)49, i ndryshuar.

SEKSIONI 10 FILLIMI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

10.1 Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Njoftimi për ratifikimin e tij bëhet me shkrim dhe dërgohet menjëherë në SHAPE. Ky memorandum mbetet në fuqi, përveç kur përfundohet nga njëra palë, duke njoftuar me shkrim 6 muaj më parë të gjitha palët e tjera.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksionit 6, 7 dhe 9 do të mbeten në fuqi, në rast të tërheqjes së ndonjë pjesëmarrësi ose pas përfundimit të këtij memorandum mirëkuptimi, deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Vendet dërguese do të përmbushin të gjitha detyrimet në rast të çdo përfundimi ose tërheqjeje.

SEKSIONI 11 NDRYSHIMET DHE INTERPRETIMI

11.1 Ky memorandum mirëkuptimi mund të modifikohet ose ndryshohet me shkrim, me pëlqimin e përbashkët të të gjitha palëve.

11.2 Çdo konflikt për interpretimin dhe zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi do të zgjidhet me konsultim mes palëve në nvielin më të ulët të mundshëm dhe nuk do t'i referohet për zgjidhje një gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare ose një pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky memorandum mirëkuptimi është firmosur në tri kopje në gjuhën angleze.

Memorandumi paraprirës paraqet mirëkuptimin e plotë mbi çështjet e referuara në këtë dokument, të arritur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem të Forcave Aleate të Europës (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT).

Nënshkruara

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Komandën Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe Shtabin e Komandës Supreme Aleate për Transformim

SHTOJCA A E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT DOKUMENTET E REFERENCËS

- a) Traktati i Atlantikut të Veriut më 4 prill 1949.
- b) Marrëveshja ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951.
- c) Marrëveshja ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1995.
- d) Protokolli për statusin e shtabeve ushtarake ndërkombëtare të ngritura në vijim të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit), datë 28 gusht 1952.
- e) Dokumenti bazë i Partneritetit për Paqe, i lëshuar nga kryetarët e shteteve dhe vendet pjesëmarrëse, në mbledhjen e Këshillit të Atlantikut Verior më 10 janar të vitit 1994.
- f) Protokolli shtesë i mëtejshëm i marrëveshjes midis shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, lidhur me statusin e forcave të tyre, 19 dhjetor 1997.
- g) MC 319/1 – Parimet dhe politikat logjistike të NATO-s.
- h) MC 334/1-Parimet dhe politikat e NATO-s për mbështetjen e vendit pritës.
- i) STANAG-et e aplikueshme të NATO-s dhe direktivat orientuese për mbështetjen logjistike, mbrojtjen e forcave dhe rimbursimi financiar.
- j) AJP-4,5 (A) – Publikimet e përbashkëta të aleancës në lidhje me doktrinat dhe procedurat e mbështetjes së vendit pritës.
- k) CM (2002)50 – Masat mbrojtëse për trupat civilë dhe ushtarakë të NATO-s, dislokimi i forcave dhe bazave ushtarake të NATO-s (Asetet) kundër kërcënimeve terroriste.
- l) Bi-SC Direktivat e mbrojtjes së forcave 80-25, 1 janar 2003.
- m) Bi-SC Guida e planifikimit veprues për mbrojtjen e forcave.
- n) AAP-6-Fjalori i terminologjisë.
- o) C-M (2002)49 – siguria brenda organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

SHTOJCA B E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Notë pranimit (NOA) për të marrë pjesë në MVP dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera që lindin në Republikën e Shqipërisë (vendi pritës) për operacionin/stërvitjen

Qeveria e _____ (Vendi dërgues) përfaqësuar nga _____
Duke vendosur që forcat e tij të armatosura do të vendosin të marrin pjesë në operacionin/stërvitjen _____.

Duke konsideruar konceptin e operacionit/stërvitjes të NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s, dhe

Duke dëshiruar të marrin pjesë në rregullimet lidhur me MVP dhe përgjegjësitë financiare ose të tjera të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (vendi pritës), Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe vendeve të tjera dërguese, në lidhje me mbështetjen e forcave të tyre të armatosura gjatë operacionit/stërvitjes:

Zgjedhin të marrin pjesë në dhe të mbështeten, nga dispozitat e parashikuara në:

Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës, gjatë operacionit/stërvitjes së NATO-s _____ (MM për MVP), e cila ka hyrë në fuqi më _____, si më poshtë;

Si vend dërgues për operacionin e NATO-s _____, për planifikimin, përgatitjen dhe pjesëmarrjen e memorandumit të mirëkuptimit të lartpërmendur (Në rast se ka rezerva këto do të shtohen në fjali “subjekt i rezervave të mëposhtme”, dhe pas kësaj do të jepet lista e rezervave, nëse nevojitet).

Për qeverinë e _____ (vendi dërgues)

Datë

SHTOJCA C E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Deklarim qëllimi (SOI) për të marrë pjesë në MVP dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera që lindin në Republikën e Shqipërisë (vendi pritës) për operacionin/stërvitjen

Qeveria e _____ (vendi dërgues), përfaqësuar nga _____

Duke vendosur që forcat e tij të armatosura do të vendosin të marrin pjesë në operacionin/stërvitjen;

Duke konsideruar konceptin e operacionit/stërvitjes të NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s, dhe

Duke dëshiruar të marrin pjesë në rregullimet lidhur me MVP dhe përgjegjësitë financiare ose të tjera të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (vendi pritës), Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe vendeve të tjera dërguese, lidhur me mbështetjen e forcave të tyre të armatosura gjatë operacionit/stërvitjes:

Zgjedhin të marrin pjesë në dhe të mbështeten nga dispozitat e parashikuara në:

Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës, gjatë operacionit/stërvitjes të NATO-s _____ (MM për MVP), e cila ka hyrë në fuqi më _____ si më poshtë:

Si vend dërgues, për operacionin e NATO-s _____ për planifikimin, përgatitjen dhe pjesëmarrjen e memorandumit të mirëkuptimit të lartpërmendur. (Në rast se ka rezerva, këto do të shtohen në fjali “subjekt i rezervave të mëposhtme” dhe pas kësaj do të jepet lista e rezervave, nëse nevojitet).

Për qeverinë e _____ (vendit dërgues)

Data

LIGJ

Nr.10 018, datë 13.11.2008

PËR AVOKATURËN E SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit.

Neni 2

Avokatura e Shtetit

1. Avokatura e Shtetit është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, me seli në Tiranë.

2. Avokatura e Shtetit është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Asistenca juridike përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit. Për institucionet dhe për çështjet juridike të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, asistenca juridike e Avokaturës së Shtetit është e detyrueshme. Në Avokaturën e Shtetit, funksioni i këshillimit juridik kryhet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit.

3. Avokatura e Shtetit organizohet dhe e ushtron veprimtarinë sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. Buxheti i Avokaturës së Shtetit është zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 3

Parimet e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit

Avokatura e Shtetit e ushtron veprimtarinë në bazë të parimeve të profesionalizmit, të efijencës, të unitetit të doktrinës, të përgjegjësisë dhe korrekhtësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AVOKATURËS SË SHTETIT

Neni 4

Organizimi i Avokaturës së Shtetit

1. Avokatura e Shtetit drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor.

2. Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:

a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;

b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;

c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;

ç) zyra e inspektimit.

3. Avokatura e Shtetit në nivel vendor përbëhet nga:

a) zyrat vendore, të cilat veprojnë pranë çdo gjykate apeli, ku ushtrojnë dhe kompetencën tokësore;

b) avokatët e shtetit pranë ministrive.

4. Avokatura e Shtetit ka në përbërjen e saj edhe administratën mbështetëse. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të administratës mbështetëse rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës.

5. Struktura dhe organika e Avokaturës së Shtetit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

6. Mënyra e organizimit dhe bashkërendimit të punës, ndërmjet niveleve dhe zyrave në Avokaturën e Shtetit, përcaktohet në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, të propozuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

7. Marrëdhëniet ndërmjet Avokaturës së Shtetit, institucioneve shtetërore dhe enteve publike, roli i avokatëve të shtetit në gjykim, si edhe normat procedurale të posaçme përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Funksionet e Avokaturës së Shtetit

1. Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:

a) ofron shërbim këshillimor për veprimtarinë juridike të organeve të administratës shtetërore qendrore dhe të enteve publike, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin;

b) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kriterëve lëndore dhe sasiorë, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës;

c) u ofron asistencë juridike njësisve të qeverisjes vendore, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme, të lidhura për këtë qëllim, ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore;

ç) bashkërendon punën me prokurorinë për mbrojtjen, në gjykim, të interesave të shtetit për çështjet civile, zgjidhja e të cilave bëhet gjatë një procesi penal;

d) përcakton rregulla për unifikimin e praktikave dhe formulimin e kriterëve të përgjithshme të asistencës juridike të shtetit;

dh) ndërmjetëson për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike;

e) ka të drejtën e nisjes së veprimeve ligjore, me qëllim për të shfuqizuar aktet juridike dhe kontratat administrative, si edhe për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në pajtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural dhe në këtë ligj, me autorizim paraprak të organit administrativ të interesuar, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

ë) ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës.

2. Avokatura e Shtetit nuk jep asistencë juridike:

a) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve qendrore të administratës publike;

b) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve të qeverisjes vendore, për ato raste kur asistencë juridike ofrohet në përputhje me shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni;

c) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe organeve të qeverisjes vendore, për organet e qeverisjes vendore, pavarësisht nga marrëveshja e lidhur sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 6

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ushtron këto kompetenca:

a) drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij;

b) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;

- c) përcakton ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe të kërkesave për dhënie mendimi me shkrim në të dyja nivelet;
- ç) jep udhëzime të brendshme për trajtimin e çështjeve gjyqësore apo të këshillimeve ligjore;
- d) miraton rregulla të posaçme për unifikimin e praktikave të këshillimit, përfaqësimit dhe ndërmjetësimit, të ndjekura nga avokatët e shtetit;
- dh) shqyrton dhe vendos për kërkesat e avokatëve të shtetit në të dyja nivelet, për ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore;
- e) urdhëron kryerjen e inspektimeve në të dyja nivelet e Avokaturës së Shtetit;
- ë) i raporton Ministrit të Drejtësisë, jo më pak se një herë në muaj, për veprimtarinë e kryer nga Avokatura e Shtetit, duke vënë në dukje mangësitë e mundshme ligjore dhe nevojat për ndryshime përkatëse;
- f) i paraqet një raport vjetor Ministrit të Drejtësisë dhe nëpërmjet tij Këshillit të Ministrave për dëmin e shkaktuar ndaj interesave publikë nga veprimet e organeve të administratës publike, të konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;
- g) i raporton Ministrit të Drejtësisë, me kërkesë të këtij të fundit ose me nismën e vet, për çështje të veçanta, për të cilat ka marrë dijeni para dhe gjatë përfaqësimit të mbrojtjes së interesave shtetërorë;
- gj) i propozon Ministrit të Drejtësisë ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi;
- h) i propozon për miratim Ministrit të Drejtësisë kandidaturat për drejtuesit e strukturave, nga radhët e avokatëve të shtetit, në nivel qendror dhe vendor;
- i) në raste të veçanta, përfaqëson vetë institucionin para gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- j) planifikon dhe administron buxhetin vjetor të Avokaturës së Shtetit.

KREU III AVOKATURA E SHTETIT NË NIVEL QENDROR

Neni 7

Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare

1. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare është struktura në nivel qendror, përgjegjëse për përfaqësimin e interesave pasurorë të shtetit pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Në raste të veçanta, me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, avokatët e shtetit të këtij sektori kryejnë përfaqësimin edhe gjykatave të tjera kombëtare.
2. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.
3. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 8

Zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror

1. Zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror është struktura përgjegjëse për ushtrimin e funksionit këshillimor të Avokaturës së Shtetit për bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen e avokatëve të shtetit pranë ministrive, për funksionet e tyre këshillimore.
2. Zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.
3. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 9

Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar

1. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe

organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.

2. Kjo zyrë përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji. Njëri prej avokatëve të shtetit të kësaj zyre, me propozimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, caktohet nga Ministri i Drejtësisë si përfaqësuesi ligjor i Republikës së Shqipërisë në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

3. Përfaqësuesi ligjor i Republikës së Shqipërisë në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në ushtrimin e kompetencave të tij, sipas këtij ligji, ndihmohet nga juristë.

4. Pranë misionit të përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, me propozimin e përfaqësuesit ligjor dhe miratimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, caktohet një nga juristët, si përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, i cili vepron në emër të përfaqësuesit ligjor.

5. Juristët, të cilët veprojnë pranë kësaj zyre, gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe emërohen në detyrë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

6. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 10

Zyra e inspektimit

1. Zyra e inspektimit është struktura në nivel qendror, përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e organizimit, si dhe kryerjen e funksioneve mbështetëse, në rastet kur vihen re pamjaftueshmëri në burime, materiale dhe njerëzore, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit.

2. Zyra e inspektimit përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.

3. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

KREU IV

AVOKATURA E SHTETIT NË NIVEL VENDOR

Neni 11

Zyrat vendore, të cilat veprojnë pranë çdo gjykate apeli

1. Zyrat vendore pranë gjykatave të apelit janë strukturat përgjegjëse, në nivel vendor, për dhënien e asistencës juridike institucioneve shtetërore dhe enteve publike të njësisë territoriale, nën juridiksionin e saj.

2. Zyrat vendore pranë gjykatave të apelit përbëhen nga avokatë të shtetit dhe drejtohen nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.

3. Funksioni i drejtuesit të zyrës vendore, e cila ka në organikën e saj vetëm një avokat shteti, kryhet nga ky avokat.

4. Rastet e konfliktit të kompetencave territoriale ndërmjet zyrave vendore zgjidhen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

5. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

6. Ministri i Drejtësisë siguron dhe garanton mirëfunksionimin e zyrave vendore në mjedise shtetërore.

Neni 12

Avokatët e shtetit pranë ministrive

1. Pranë çdo ministrie emërohen avokatë të shtetit, të cilët ushtrojnë funksione këshillimore, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Funksioni i përfaqësimit dhe mbrojtjes në gjyq të interesave të institucioneve, pranë të cilave veprojnë avokatët e shtetit, ushtrohet prej tyre në rastet dhe çështjet e përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Avokatët e shtetit pranë ministrive kanë varësi të dyfishtë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe nga titullari i institucionit, pranë të cilit veprojnë.

4. Në realizimin e funksioneve këshillimore, në mbrojtje të interesave të shtetit, sipas objektivit të veprimtarisë së këtij ligji, avokatët e shtetit pranë ministrive kanë varësi funksionale nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe varësi administrative nga titullari i institucionit, pranë të cilit veprojnë.

5. Funksioni këshillimor i avokatit të shtetit pranë ministrive realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tij në hartimin e akteve juridike të institucionit, pranë të cilit ai vepron dhe të institucioneve të varësisë, që sjellin pasoja juridike me karakter financiar për shtetin.

6. Mënyra e bashkërendimit të punës së avokatëve të shtetit pranë ministrive me strukturat juridiko-profesionale të këtyre institucioneve dhe raportet ndërmjet Avokaturës së Shtetit, Ministrisë të Drejtësisë dhe titullarëve të ministrive përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

7. Trajtimi financiar i avokatëve të shtetit pranë ministrive, sipas niveleve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat në Avokaturën e Shtetit, mbulohet nga buxheti i Avokaturës së Shtetit.

KREU V

VEPRIMTARIA E AVOKATURËS SË SHETITIT DHE MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE

Neni 13

Fillimi i gjykimit për pavlefshmëri të veprimeve juridike ose të kontratave administrative

1. Avokatura e Shtetit, sipas kërkesës së motivuar të organit përgjegjës të institucionit të interesuar, ka të drejtë të fillojë procedurat për ngritjen e padisë, me objekt për pavlefshmëri të veprimit juridik, që tjetëron ose disponon pasurinë shtetërore, në favor të të tretëve, ose për pavlefshmëri të kontratave administrative, të lidhura me të tretë.

2. Avokatura e Shtetit, përpara se të depozitojë padinë në gjykatë, i paraqet organit të interesuar një raport të hollësishëm për gjendjen e fakteve dhe të ligjit, kostot e pritshme të gjykimit, si dhe për çdo shpenzim të zakonshëm/të jashtëzakonshëm apo çdo dëmshpërblim pasuror/jopasuror, që pala tjetër mund të pretendojë ose të fitojë gjatë apo pas përfundimit të gjykimit për shpalljen e pavlefshme të kontratës ose të veprimit juridik. Në këtë raport, Avokatura e Shtetit është e detyruar të shprehë qëndrimin për ngritjen ose jo të padisë.

3. Organi i interesuar, pasi njihet me raportin e Avokaturës së Shtetit, të hartuar sipas pikës 2 të këtij neni, jep pëlqimin për ngritjen ose jo të padisë.

Neni 14

Mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal

1. Drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor njofton Avokaturën e Shtetit brenda 7 ditëve nga data e regjistrimit të procedimit penal për vepra penale, nga të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë.

2. Avokatura e Shtetit ngre padi civile në procesin penal për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale.

3. Avokatura e Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni organit qendror ose vendor të administratës, që ka interes të drejtpërdrejtë, ose organit epror të personit juridik publik, në rast se vlera e dëmit është më pak se 1 milion lekë. Delegimi është i vlefshëm për gjykimin në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit.

Neni 15

Këshillimi

1. Avokatura e Shtetit, në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të shtetit, u jep mendim me shkrim organeve të administratës publike, kur kjo i kërkohet prej tyre, në veçanti, për të vënë në lëvizje, për të kundërshtuar ose për të tërhequr çështje në gjykim.

2. Funksioni këshillimor i Avokaturës së Shtetit ka karakter këshillues për institucionet

kërkuese dhe ka të bëjë me dhënien e mendimeve, të formuluar në bazë të një analize të mirëfilltë juridike të çështjes, objekt këshillimi dhe të pasojave juridike, që ato mund të sjellin. Në asnjë rast, këshillimi nuk mund të jetë vlerësim mbi qëllimin e nxjerrjes së aktit juridik.

3. Avokatura e Shtetit, kur i kërkohet, jep paraprakisht mendim për projektet e kontratave të organeve të administratës publike, enteve publike dhe subjekteve, ku shteti është pronar i vetëm ose bashkëpronar, si dhe mund t'u përgatisë këtyre kontrata të rëndësishme.

4. Për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave administrative, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, këshillimi i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm. Në këto raste, këshillimi i organeve të administratës publike me Avokaturën e Shtetit zgjat deri në përmbushjen e detyrimeve të kontratave nga palët nënshkruese.

5. Këshillimi i dhënë nga Avokatura e Shtetit institucioneve shtetërore dhe enteve publike, sipas këtij neni, nuk ka karakter detyrues për to, përveç rasteve kur parashikohet si i tillë me ligj.

6. Avokatura e Shtetit bën sugjerime për procedimet administrative, me natyrë konfliktuale, të cilat mund të bëhen shkak për lindjen e konflikteve gjyqësore.

7. Ministri i Drejtësisë mund ta ngarkojë Avokaturën e Shtetit të japë mendim për projektaktet, që lidhen me veprimtarinë e organeve të administratës publike.

8. Asnjë organ i administratës publike apo ent publik nuk mund të kërkojë drejtpërdrejt ndihmë juridike nga avokatë në profesion të lirë, me përjashtim të rasteve të veçanta, sipas rregullave që do të vendosen nga Këshilli i Ministrave.

9. Mendimi këshillimor, i dhënë nga Avokatura e Shtetit, sipas dispozitave të këtij ligji, jepet në çdo rast me shkrim dhe është pjesë përbërëse e praktikës, për të cilën kërkohet këshillimi.

Neni 16

Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore

1. Organet e administratës publike detyrohen t'i japin Avokaturës së Shtetit të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e nevojshme, që lidhen me procesin gjyqësor apo këshillimor, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës pranë këtyre institucioneve.

2. Marrëdhëniet ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe ministrive realizohen nëpërmjet avokatëve të shtetit, të emëruar pranë këtyre ministrive, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

3. Në rast se nga organet e administratës publike nuk respektohet parashikimi i mësipërm, Avokatura e Shtetit njofton Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë.

4. Gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, Avokatura e Shtetit merr parasysh udhëzimet e dhëna, në çdo rast me shkrim, nga organi apo enti i interesuar, përveç rasteve kur ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi ose interesin publik.

Neni 17

Ndërmjetësimi dhe pajtimi

1. Avokatura e Shtetit ndërmjetëson për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike. Zgjidhja, për të cilën është rënë dakord nga palët, u përcillet për miratim, nga Avokatura e Shtetit, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave. Miratimi i dhënë prej tyre materializohet në një urdhër të përbashkët dhe, vetëm pas kësaj, bëhet i detyrueshëm për palët në mosmarrëveshje.

2. Avokatura e Shtetit rekomandon zgjidhje me pajtim për mosmarrëveshjet ndërmjet një organi qendror ose vendor të administratës publike dhe një organi tjetër qendror ose vendor, kur ata e kërkojnë këtë zgjidhje. Nuk mund të jepen rekomandime për çështje të mosmarrëveshjeve për kompetencat.

Neni 18

Kontraktimi i shërbimeve të përfaqësimit dhe të konsulencës

1. Në çështje të rëndësishme për interesat e shtetit, ose kur natyra e çështjes kërkon juristë të specializuar në fusha të veçanta, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me miratimin e Ministrit të Drejtësisë, kontraktin avokatë ose zyra avokatie, vendase ose të huaja, në përfaqësim dhe mbrojtje të interesave të shtetit shqiptar, sipas një procedure konkurrimi.

2. Procedurat dhe kriteret për kontraktimin e avokatëve/zyrave të avokatisë, si dhe për pagesën e tyre përcaktohen me rregullore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 19

Përgjithshmi nga tarifat

Avokatura e Shtetit përjashtohet nga detyrimi për pagimin e tarifave gjyqësore dhe për veprimet e shërbimet, që kryhen nga administrata gjyqësore, prokuroria dhe përmbaruesi gjyqësor.

KREU VI

EMËRIMI DHE LARGIMI NGA DETYRA

Neni 20

Kushtet për t'u emëruar avokat i shtetit

1. Avokat i shtetit mund të emërohet çdo shtetas shqiptar, që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë përfunduar studimet e larta për drejtësi;
- b) të ketë një përvojë pune në praktikën gjyqësore ose administrative prej të paktën 5 vitesh;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, ose të mos jetë larguar nga shërbimi civil apo çdo funksion tjetër publik për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;

ç) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas dispozitave të këtij ligji;

d) të kalojë me sukses procesin përzgjedhës përkatës për pozicionin e Avokatit të Shtetit.

2. Në rastin e shtetasit shqiptar, të diplomuar për drejtësi, me rezultate të larta, në universitete të njohura të huaja, apo të diplomuar në shkolla pasuniversitare, ekuivalente me Shkollën e Magjistraturës, kushti i përvojës në punë, i përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, është të paktën 3 vjet.

3. Të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës përjashtohen nga kushti i përvojës në punë, të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 21

Emërimi

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, nga radhët e juristëve, që plotësojnë kushtet për të qenë avokat i shtetit dhe që kanë, të paktën, 10 vjet përvojë në profesion.

2. Avokati i shtetit emërohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit pas një konkurrimi të hapur publik.

3. Procedurat e konkurrimit zhvillohen sipas legjislationit në fuqi për nëpunësin civil. Procesi i përzgjedhjes konsiston në kapërcimin e disa fazave dhe përfshin: fazën hyrëse, fazën e formimit të posaçëm, sipas specialiteteve dhe fazën e provimit përfundimtar.

Rregulla më të hollësishme për zhvillimin e këtij procesi përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit, të parashikuar në nenin 4 pika 6 të këtij ligji.

4. Drejtuesit e strukturave të Avokaturës së Shtetit, në të dyja nivelet, emërohen nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, sipas nenit 6 të këtij ligji.

5. Shkarkimi nga detyra i drejtuesit të strukturave të Avokaturës së Shtetit, në të dyja nivelet, bëhet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 22

Zëvendësimi

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit zëvendësohet në detyrë, në mungesë dhe me porosi të tij, nga njëri prej drejtuesve të zyrave në Avokaturën e Shtetit në nivel qendror.

2. Në rastet kur vendi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit mbetet vakant, me urdhër të Kryeministrit dhe me propozim të Ministrit të Drejtësisë, mund të emërohet, përkohësisht, deri në emërimin e Avokatit të ri të Përgjithshëm të Shtetit, njëri prej avokatëve të shtetit në detyrë pranë Avokaturës së Shtetit në nivel qendror.

Neni 23

Papajtueshmëria

Avokati i Shtetit nuk mund të kryejë funksione të tjera, publike apo private, të cilat bien ndesh me detyrat funksionale, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24

Konflikti i interesave

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si dhe çdo avokat i shtetit nuk mund të përfaqësojnë shtetin, në rast se ka interesa, të njohura ose jo publikisht, për çështjen në gjykim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

2. Avokati i shtetit nuk mund të ushtrojë detyrën pranë zyrës vendore, nën juridiksionin e së cilës ushtrojnë profesionin e gjyqtarit, prokurorit ose të avokatit, bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, vëllai, motra ose prindërit.

Neni 25

Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Avokatët e shtetit, në përfundim të çdo viti kalendarik, i nënshtrohen një procedure vlerësimi të aftësive profesionale nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, duke pasur parasysh edhe rezultatet e arritura në proceset gjyqësore, që kanë përfaqësuar gjatë periudhës së vlerësimit.

2. Kriteret, rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

3. Vlerësimi për paaftësi profesionale përbën shkak për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra të avokatit të shtetit.

Neni 26

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra

1. Avokatët e shtetit lirohen nga detyra kur:

- a) japin dorëheqjen;
- b) mbushin moshën e pensionit;
- c) mungojnë në detyrë për një periudhë kohore më të gjatë se 3 muaj;
- ç) u është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjykatë të formës së prerë.

2. Avokatët e shtetit shkarkohen nga detyra vetëm në rastet kur:

- a) vërtetohet paaftësia profesionale;
- b) merret ndaj tyre masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji;
- c) dënohen me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3. Akti i lirim/shkarkimit nga detyra të avokatit të shtetit nënshkruhet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit të Drejtësisë.

KREU VII

PAGA DHE SHPËRBLIMI

Neni 27

Paga e avokatit të shtetit, e juristëve dhe e punonjësve të administratës mbështetëse

rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Shpërblimi i posaçëm

Për çështje gjyqësore të vështira dhe me interes të madh ekonomik e financiar për Republikën e Shqipërisë, avokatit të shtetit i jepet shpërblim i posaçëm. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e këtij shpërblimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 29

Përgjegjësia disiplinore

1. Avokati i shtetit i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Avokati i shtetit ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 30 të këtij ligji.

Neni 30

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet disiplinore ndahen në:
 - a) të lehta;
 - b) të rënda;
 - c) shumë të rënda.
2. Janë shkelje të lehta aktet dhe sjelljet si më poshtë:
 - a) veprimet dhe mosveprimet e avokatit të shtetit, të cilat passjellin zvarritje të proceseve gjyqësore;
 - b) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë;
 - c) akte dhe sjellje të tjera, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit.
3. Janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet si më poshtë:
 - a) zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të avokatit të shtetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, kur ajo ka passjellë ose mund të sillte pasoja për interesat pasurorë të shtetit;
 - b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë, në rastet kur ky veprim ka sjellë ose mund të sillte pasoja të rënda për interesat pasurorë të shtetit;
 - c) bërja publike e akteve ose e dokumenteve zyrtare, e të dhënave apo regjistrimeve me karakter sekret ose konfidencial;
 - ç) pengimi i inspektimeve të kryera sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - d) thyerja e disiplinës në punë, në mënyrë të përsëritur dhe pas paralajmërimit të dhënë me shkrim nga eprori;
 - dh) humbja e çështjes gjyqësore, si rezultat i nivelit të dobët të përfaqësimit në proces.
4. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet si më poshtë:
 - a) rastet, kur provohet se avokati i shtetit ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjakë apo të personave, me të cilët ka lidhje familjare;
 - b) rastet kur provohet se avokati i shtetit, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka krijuar favore për persona të tjerë, në dëm të interesave të shtetit;
 - c) rastet kur avokati i shtetit shkel dispozitat e këtij ligji dhe të kodit të etikës, të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
 - ç) rastet kur avokati i shtetit ka këshilluar në kundërshtim me interesat e institucionit qendror, që ka kërkuar konsulencën;
 - d) rastet kur provohet se ka shkelur urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

- dh) rastet kur avokati i shtetit kryen vepra penale, që lidhen me ushtrimin e detyrës;
- e) akte dhe sjellje të tjera, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit.

Neni 31

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore për avokatët e shtetit, në të dyja nivelet, jepen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, sipas një procedure disiplinore, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Masa disiplinore jepet në përputhje të drejtë me shkeljen e kryer.

3. Llojet e masave disiplinore janë:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) shkarkim nga detyra.

4. Kur provohet, sipas dispozitave të këtij ligji, se avokati i shtetit ka kryer të paktën njërën nga shkeljet e parashikuara në pikën 4 të nenit 30 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 3 të këtij neni.

5. Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen nëse, brenda 1 viti nga data e dhënies së masës “vërejtje me shkrim” dhe brenda 2 vjetëve nga data e dhënies së masës “vërejtje me paralajmërim”, ndaj avokatit të shtetit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

Neni 32

Procedimi disiplinor

1. Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj avokatit të shtetit e ka Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

2. Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së saj.

Neni 33

Ankimi ndaj masave disiplinore

Ndaj masës disiplinore të dhënë, avokati i shtetit ka të drejtë të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Regjimi kalimtar

1. Të gjitha praktikat dhe proceset në trajtim nga Avokatura e Shtetit, të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi, në kohën e nisjes së tyre.

2. Deri në miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, zyrat në nivel qendror dhe vendor të Avokaturës së Shtetit ushtrojnë të gjitha kompetencat e parashikuara në dispozitat e ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar.

3. Struktura dhe organika e përfaqësuesit ligjor, e cila funksionon sipas dispozitave të ligjit nr.8456, datë 11.2.1999 “Për funksionet e përfaqësuesit ligjor pranë organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut” pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe fondet buxhetore të dhëna për të integrohen në institucionin e Avokaturës së Shtetit, duke filluar nga data 1 janar 2009.

4. Të gjithë avokatët e shtetit në detyrë do t'i nënshtrohen një provimi teorik. Përjashtohen nga ky detyrim të gjithë avokatët e shtetit, të cilët aktualisht gëzojnë statusin e magjistratit, gjyqtarit,

prokurorit, si dhe kanë titull shkencor. Personat që nuk e kalojnë me sukses procesin për zgjedhës të posaçëm, do të qëndrojnë përkohësisht në funksionet e tyre, derisa të zëvendësohen nga një avokat i shtetit. Këtyre personave nuk u mohohet e drejta për të marrë pjesë në proceset e zakonshme të përzgjedhjes së Avokatëve të Shtetit, sipas nenit 21 të këtij ligji.

5. Rregullat për organizimin e provimit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, sipas në nenit 4 pika 6 të këtij ligji.

Neni 35

Sanksione

1. Kur detyrimi për njoftim, sipas nenit 16 të këtij ligji, nuk është bërë në kohë, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton titullarin e organit apo të entit publik, që i përket ky detyrim.

2. Kur njoftimi, sipas nenit 16 të këtij ligji, nuk është bërë dhe nga ky veprim kanë ardhur pasoja, personi i ngarkuar për kryerjen e njoftimit përgjigjet sipas legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë civile. Në këto raste, organi i administratës publike apo ai i entit publik kanë të drejtë të ngrenë padi regresi në gjykatë.

Neni 36

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 pika 7, nenit 18 pika 2, nenit 27 dhe nenit 28 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 pika 6 dhe nenit 7 pika 3 të këtij ligji.

3. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të nxjerrë aktet e nevojshme në zbatim të nenit 30 pika 4 shkronja “c” të këtij ligji.

Neni 37

Shfuqizime

Ligjet nr.8551, datë 18.11.1999 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar dhe nr.8456, datë 11.2.1999 “Për funksionin e përfaqësuesit ligjor pranë organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2009.

**Shpallur me dekretin nr.5951, datë 24.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM

Nr.225, datë 13.11.2008

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet struktura e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.


II. Miratohet organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.

III. Paga e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është në raportin 0,6 për qind të pagës së Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Efektet financiare të pagës së Komisionerit fillojnë nga data e emërimit të tij në detyrë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**STRUKTURA E ZYRËS SË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**



ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS
TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri	1	D <i>Ligji nr. 9584, neni 4</i>
Këshilltar	1	II - b
Sekretar	1	IV - a
II. Drejtoria e Regjistrimit		
Drejtor	1	II - b
Specialistë	4	III - b
III. Drejtoria e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë		
Drejtor	1	II - b
Specialistë	5	III - b
IV. Drejtoria e Hetim - Inspektimit		
Drejtor	1	II - b
Inspektorë	4	III - b
V. Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun		
Drejtor	1	II - b
Specialist	1	III – b
V/1. Sektori i Teknologjisë së Informacionit		
Specialistë	2	III - b
VI. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse		
Drejtor	1	II - b
Specialist i burimeve njerëzore	1	III - b
Specialist financë-buxhet	1	IV – a
Specialist protokoll – arkiv	1	IV - b
Magaziner/ punonjës mirëmbajtjeje	1	Kl. (VKM 1231, dt. 2.7.2008)
Shofer i titullarit	1	Kl. “
Punonjëse pastrimi	1	Kl. “
Gjithsej	30 punonjës	

VENDIM
Nr.1306, datë 24.9.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1203, DATË 27.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË SAKTË, NË PËRQINDJE, TË RENTËS
SË PASURISË MINERARE, SIPAS VLERËS SË TREGUT, PËR ÇDO MINERAL APO
GRUP MINIERALESH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1203, datë 27.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në rastet kur mineralet përdoren për prodhim nënproduktesh (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike), të cilat eksportohen, renta minerare do të aplikohet në doganë, mbi vlerën e mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit. Kjo vlerë do të llogaritet në bazë të faturave të shitjes së sasisë së mineralit, të përdorur për prodhimin e nënproduktit. Në rastin kur eksportuesi i nënproduktit (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) është njëkohësisht edhe prodhues i mineralit, përqindja e rentës minerare do të llogaritet mbi koston e prodhimit (nxjerrjes) të mineralit të përdorur. Kjo vlerë përcaktohet në bazë të sasisë së produktit përfundimtar (koncentrat apo prodhime metalurgjike), të deklaruar në doganë, si dhe të normativave korresponduese të mineralit të përdorur. Normativat dërgohen periodikisht nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pranë Ministrisë së Financave, dhe publikohen në uebsaitin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Për të gjitha kategoritë e tjera të nënprodukteve minerare, të cilat mund të derivohen nga mineralet e përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.1203, datë 27.8.2008 të Këshillit të Ministrave, dhe për të cilat Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nuk ka përcaktuar normativa korresponduese të mineraleve, që janë përbërës të këtij nënprodukti, kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të mineralit është njëkohësisht edhe përpunues, renta minerare do të aplikohet mbi koston e prodhimit (nxjerrjes) të mineralit, kosto, e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet pranë organeve tatimore, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**UDHËZIM
Nr.17/3, datë 13.11.2008**

**PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHITUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 35 e 58 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, në pikën 9.4 “Furnizimi i karburanteve”, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas germës b) “Detyrime të palëve”, shtohen germet c, ç, d dhe dh, me përmbajtje si më poshtë:

“c) Furnizimi i karburantit ndërmjet shoqërive të tregtimit me shumicë (shoqërive anonime), kryhet vetëm në rastin kur janë importuese dhe kanë magazina doganore, shesin me njëra-tjetrën karburant vetëm në regjimin tranzit, konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës dhe vlera e tatueshme e tij përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

Ky rast aplikohet edhe në rastin kur një prodhues vendas furnizon një shoqëri të tregtimit me shumicë.

ç) Kur karburanti i furnizuar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë është i destinuar të konsumohet për veprimtarinë ekonomike të konsumatorëve të mëdhenj, për nevoja të institucioneve apo enteve publike, si dhe për eksport, vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

d) Kur karburanti furnizohet me tollona, në momentin e dorëzimit të tollonave, apo nëse më parë është bërë ndonjë pagesë, shoqëria furnizuese lëshon faturë tatimore për përfituesin e tollonave dhe lëshimi i faturës, përbën momentin e furnizimit.

Vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

Stacionet e shitjes me pakicë, në fund të muajit regjistrojnë shitjet me tollona në mënyrë që të evidentohen qartë sasitë e shitura për llogari të secilës shoqëri lëshuese të tollonave. Shumat e tollonave hidhen në fund të muajit në një faturë tatimore përmbledhëse, e cila paraqitet në librin e shitjes, por pa efekte (pasi deklarimi është bërë më parë në momentin e dorëzimit të tollonave), pra ato deklarohen me storno.

Si provë e këtij furnizimi shërben kontrata e lidhur midis shoqërisë furnizuese me tollona dhe klientit në të cilën përveç të tjerash, paraqitet dhe sasia dhe çmimi i karburantit të furnizuar.

dh) Klientëve, persona të tatueshëm, të furnizuar nga shoqëritë e shitjes me pakicë, apo ato të shitjes me shumicë të karburanteve, u lind e drejta e kreditimit të TVSH-së të paraqitur në faturat tatimore të lëshuara prej këtyre furnizuesve, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

e) Në të njëjtën zonë, kryesori nuk mund të faturojë tek pikat e treta çmime më të ulëta se çmimi i akorduar pikave të shitjes nën pronësinë e tij.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Financave
Ridvan Bode

VENDIM Nr.14, datë 21.7.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 16.1.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.55/9 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E APELIT PËR KRIME TË RËNDA, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM, përfaqësuar nga prokurori Saliko Hajno, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me nenin 148/1 të Kushtetutës, i neneve 24 pikat 2 dhe 5, 323 pika 1, 327 pika 2 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, germa “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, mbi kallëzimin e shtetasit J.M. ka nisur procedimin penal nr.58 në ngarkim të shtetasit K.H., për veprën penale të “Shtërngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokuroria, mbështetur në nenin 328/1, germa “b” të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Pushimin e pjesshëm të hetimeve, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale”. Vendimi për pushimin e pjesshëm të hetimeve dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që kishte miratuar “Pushimin e çështjes”, janë shfuqizuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vendosur dërgimin e akteve të këtij procedimi penal prokurorisë për vazhdimin e hetimeve.

Në përfundim të hetimeve, prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, me të njëjtin arsyetim, ka vendosur “Pushimin e pjesshëm të hetimeve”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe më pas në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Kjo e fundit, me vendimin datë 31.7.2007, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës Kushtetuese, për t’u shprehur nëse nenet 24 pikat 2 dhe 5, 323 pika 1, 327 pika 2 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë të drejtën e prokurorit për pushimin e çështjes penale, vijnë në kundërshtim me nenin 148/1 të Kushtetutës.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vlerësuar si jokushtetuese dispozitat e kundërshtuara duke parashtruar në esencë, se:

- Vendimi i marrë nga prokurori për pushimin e çështjes ose akuzës në çdo fazë të procedimit, vjen në kundërshtim me funksionin kushtetues të tij, që është ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq, në emër të shtetit, parashikuar në nenin 148/1 të Kushtetutës.

- Kjo vendimmarrje e rëndësishme, e cila në mënyrë abuzive i lihet në diskrecion prokurorit, nuk ndjek rrugën normale të çmueshmërisë së saj prej një organi të tretë të paanshëm siç është gjykata.

- Parashikimet e këtyre dispozitave shkelin parimin e paansisë së organit të ngarkuar me

dhënie e drejtësisë e në këtë aspekt, është e pamundur të konceptohet dhënia e drejtësisë në mënyrë përfundimtare prej organit të ngarkuar me ndjekjen penale.

- Në të njëjtën situatë antikushtetushmërie qëndron dhe neni 24/5 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon të drejtën e prokurorit më të lartë për të kontrolluar (me cilësinë e gjykatës së shkallës superiore) vendimmarrjen e prokurorit më të ulët.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, kërkuar përpara Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar:

Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë:

- Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk plotësohet kushti që ligji i vlerësuar si jokushtetues të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes konkrete (neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (Ligji nr.8577). Në rastin në shqyrtim, objekt gjykimi ka qenë një vendim i prokurorisë, mbështetur në nenin 328/1, germa "b" të Kodit të Procedurës Penale. Për pasojë, kërkesa nuk mund të shtrihet në nene të tjera që nuk kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

- Pretendimi se prokuroria merr attribute të dhënies së drejtësisë nuk është i bazuar, pasi pushimi i një çështje nga ana e prokurorisë nuk mund të konsiderohet një formë e dhënies së drejtësisë, por kompetencë e prokurorisë brenda autoritetit të saj kushtetues të ndjekjes penale.

- Kompetenca që neni 24/5 i Kodit të Procedurës Penale i njeh prokurorit më të lartë, për të shfuqizuar vendimet e prokurorëve më të ulët, është në përputhje me nenin 148/2 të Kushtetutës, i cili parashikon që "Prokuroria është organ i centralizuar".

Përfaqësuesi i zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm:

- Neni 148/1 i Kushtetutës përcakton, midis të tjerave, që "Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj". Në zbatim të këtij përcaktimi, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet dispozitave të kundërshtuara, i njeh të drejtën prokurorit jo vetëm të kryejë hetimet paraprake, por dhe të vendosë mosfillimin apo pushimin e çështjes kur plotësohen disa kriterë.

- Përcaktimi i nenit 24/5 të Kodit të Procedurës Penale nuk bën fjalë vetëm për vendimet e pushimit, por ai zgjidh në parim problemin lidhur me aktet e paligjshme që mund të marrë prokurori më i ulët gjatë hetimeve paraprake. Në këtë rast, kontrolli që ushtron prokurori më i lartë është në pajtim me parimin e funksionimit të prokurorisë si organ i centralizuar, përcaktuar në nenin 148/2 të Kushtetutës.

II

1. Lidhur me pretendimin për moslegjitimimin e kërkuar

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar - Kuvendi i Shqipërisë - pretendon se pala kërkuar nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse nuk plotësohen kushtet për të iniciuar një gjykim incidental. Konkretisht, subjekti i interesuar pretendon, se nuk përmbushet kushti që ligji i vlerësuar si jokushtetues nga ana e gjykatës së juridiksionit të zakonshëm, të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes konkrete që gjykata ka në shqyrtim.

Lidhur me pretendimin e mësipërm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kushtet për fillimin e gjykimit në rrugë incidentale janë parashikuar në nenin 145/2 të Kushtetutës dhe janë detajuar në nenin 68 të ligjit 8577. Sipas këtyre dispozitave, një gjykim i tillë vihet në lëvizje kur çmohet se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në rastin në shqyrtim, përpara Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është paraqitur një ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes penale nga prokurori, vendim ky i mbështetur në nenin 328/1, germa "b" të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të çështjes kjo gjykatë ka vlerësuar se në vetvete kompetenca që i njihet prokurorit për pushimin e çështjes është në kundërshtim me nenin 148/1 të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, ka kërkuar shfuqizimin edhe të disa dispozitave të tjera të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihet neni 24, pika 2, dispozitë e cila parashikon në parim këtë kompetencë të prokurorit, që konkretizohet më tej në parashikimet e neneve 323, 327 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese konstaton se është e vërtetë sa pretendon subjekti i interesuar, se Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda i është shtruar problemi i verifikimit të ligjshmërisë së pushimit të procedimit penal, në aplikim të nenit 328/1/b të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në rastin në shqyrtim, kontrollit kushtetues duhet t'i nënshtrohen edhe

dispozitat e tjera të kundërshtuara, pasi edhe këto dispozita kanë të bëjnë me kompetencën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Një qëndrim i tillë mbështetet në nenin 48/2 të ligjit nr.8577, dispozitë, e cila përjashtimisht lejon kontrollin kushtetues edhe të akteve të tjera normative, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe këtyre akteve.

Përsa i përket parashikimit të pikës 5 të nenit 24, sipas së cilës “Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht”, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk përmbushen kushtet e nenit 68 të ligjit 8577. Kjo dispozitë jo vetëm që nuk është dispozita e zbatuar në rastin konkret, por as nuk ekziston ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë midis saj dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm. Për pasojë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk legjitimohet për kundërshtimin e kësaj dispozite në kuadrin e një gjykimi incidental.

III

Lidhur me themelin e pretendimeve të kërkuarit Gjykata Kushtetuese konstaton se, megjithëse Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka pretenduar papajtueshmërinë e dispozitave të kundërshtuara me nenin 148 të Kushtetutës, në esencë ajo ka pretenduar se këto dispozita bien ndesh edhe me nenin 135 të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese do t'i analizojë pretendimet e kërkuarit në vështrim të këtyre dy dispozitave kushtetuese.

1. Lidhur me pretendimin e papajtueshmërisë me nenin 148/1 të Kushtetutës

Pala kërkuar - Gjykata e Apelit për Krime të Rënda - në esencë, ka pretenduar se dispozitat e neneve 24 pika 2, 323 pika 1, 327 pika 2 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat parashikojnë kompetencën e prokurorit për pushimin e çështjes penale, nuk pajtohen me natyrën e funksionit të prokurorit, përcaktuar në nenin 148/1 të Kushtetutës – ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq në emër të shtetit.

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se nga Kushtetuta buron detyrimi i shtetit për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë dhe efektive të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe vlerave të tjera kushtetuese, për të garantuar sigurinë e individit dhe shoqërisë kundër akteve (veprave) kriminale. Në një shtet demokratik dhe të së drejtës, përcaktimi i veprave penale dhe i sanksioneve për to mund të bëhet vetëm me ligj. Kjo nënkupton edhe të drejtën dhe detyrimin e ligjvënësit për të rregulluar marrëdhëniet juridike procedurale penale, që kanë të bëjnë me zbulimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale.

Gjykata Kushtetuese vlerëson, se kur rregullon marrëdhënie të sferës procedurale penale ligjvënësi gëzon liri të gjerë veprimi, por duke respektuar normat dhe parimet e Kushtetutës që kanë të bëjnë me barazinë e personave në të drejta (neni 18 i Kushtetutës), të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), parimin e pavarësisë së gjykatës në dhënien e drejtësisë etj.

Kur ndërmeret rregullime të kësaj natyre, ligjvënësi, përveç parimeve të sipërpërmendura, duhet të respektojë edhe kuadrin kushtetues që sanksionon institutet e ndjekjes penale, të mbrojtjes së akuzës në emër të shtetit dhe të gjykit.

Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuar, Gjykata Kushtetuese pati parasysh natyrën e funksionit të prokurorit në aspektin kushtetues, të analizuar edhe në vendime të tjera të saj (vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 4.12.2006 dhe nr.3, datë 6.2.2008).

Sipas nenit 148 të Kushtetutës “1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si organ i centralizuar. 3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve”. Këto dispozita përbëjnë modelin e përgjithshëm të procedurës penale, por kuadri kushtetues i ndjekjes penale duhet të shihet edhe në kontekstin e parimit të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës), nga i cili burojnë edhe parime të tjera të procesit penal - si parimi i prezumimit të pafajësisë, ndalimi i gjykit dy herë për të njëjtën veprë penale, parimi i kontradiktoritetit, e drejta për t'u gjykuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e drejta e mbrojtjes, e drejta për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë etj.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se kompetenca e prokurorit për mosfillimin apo pushimin e çështjes penale (në rastet e parashikuara në ligj), si aspekt i funksionit të tij kushtetues të ushtrimit të

ndjekjes penale, është në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës. Ky parim, midis të tjerave, presupozon që shteti duhet të marrë të gjitha masat për të mbrojtur dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, të ndëshkojë çdo përpjekje të paligjshme kundër tyre, si dhe të sigurojë që asnjë person të mos ndiqet dhe dënohet penalisht në mënyrë të padrejtë.

Në kuadrin e këtij detyrimi të shtetit - që asnjë person të mos ndiqet penalisht padrejtësisht - ligjvënësi ka përcaktuar me ligj rastet e mosfillimit apo pushimit të çështjes penale, duke vendosur detyrimin që prokurori, kur plotësohet çdonjëri nga këto raste, të vendosë mosfillimin apo pushimin e akuzës, ose të çështjes penale.

Në teorinë e së drejtës procedurale penale, ndjekja penale nënkupton një aktivitet juridik procedural që ndërmerret kundër dikujt që ka shkelur ligjin. Ndjekja penale përfaqëson tërësinë e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji, me qëllim vërtetimin ose rrëzimin e akuzës së ngritur nga prokurori (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 6.2.2008).

Ndjekja penale (procedimi penal) përfshin dy faza të ndryshme, por të lidhura në mënyrë funksionale; fazën e hetimeve paraprake, që konsiston në kryerjen e veprimeve hetimore për të zbardhur ngjarjen dhe identifikuar autorin; dhe fazën e gjykimit, që përfaqësohet nga mbrojtja e akuzës përpara gjykatës. Në bazë të nenit 277 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore, por ai mund të kryejë vetë veprimet hetimore që i çmon të nevojshme. Në përfundim të veprimeve hetimore prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë (neni 327 i Kodit të Procedurës Penale).

Gjykata Kushtetuese vlerëson megjithatë, se kjo vendimmarrje e prokurorit udhëhiqet nga parimi i ligshmërisë. Kjo do të thotë se përcaktimi i rasteve (kriterëve ligjorë) të mosfillimit apo pushimit të çështjes penale është bërë në nivel qendror nga ana e shtetit/ligjvënësit. Prokurorit nuk i lejohet një *modus operandi* i tillë ku të vendosë të pushojë një çështje penale jashtë kriterëve ligjorë. Diskrecioni i prokurorit qëndron vetëm në faktin se atij i është lënë kompetenca të vlerësojë nëse, në procedimet konkrete që ka për trajtim, përmbushen ose jo këto kritere.

Kushtetutëbërësi e ka njohur prokurorinë si një organ të centralizuar që në ushtrimin e kompetencave i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ndryshe nga sa pretendon pala kërkuese, qëllimi i kushtetutëbërësit nuk ka qenë të vendosë një barrierë kushtetuese për ushtrimin në mënyrë të detyruar të ndjekjes penale, siç mund të jetë rasti i ndonjë vendi tjetër, ku Kushtetuta ka pranuar modelin e ndjekjes penale të detyrueshme, që nënkupton se prokurori nuk mund ta pushojë vetë ndjekjen penale, por duhet t'ia kërkojë këtë gjykatës. Kushtetutëbërësi ka përcaktuar qartë garancitë dhe mënyrën e funksionimit të prokurorisë, duke e shkëputur nga pushtetet e tjera, pra larg ndikimeve politike të mundshme, garanci që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Gjykata Kushtetuese thekson se pavarësia e prokurorit në organizimin e hetimeve paraprake dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë është një vlerë kushtetuese. Megjithatë, kjo pavarësi, e sanksionuar në Kushtetutë, nuk mund të interpretohet se në procesin penal, prokurorët nuk janë të detyruar të respektojnë ligjet dhe/ose udhëzimet apo vendimet e gjykatës. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët janë të pavarur nga ndikimi i pushteteve të tjera, por janë të varur nga ligji. Me fjalë të tjera, kompetencat e prokurorëve për pushimin e çështjes penale, në aspektin kushtetues, nuk lejohet të interpretohen si e drejtë subjektive e tyre, d.m.th. si e një e drejtë që ata ose e përdorin, ose mund të vendosin të mos e përdorin. Gjykata Kushtetuese shton se këto kompetenca përbëjnë edhe detyrime për prokurorët, të cilat jo vetëm që mund, por dhe janë të detyruar t'i përmbushin në qoftë se plotësohen kushtet përkatëse të sanksionuara në ligj.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se dispozitat e kundërshtuara nuk vijnë në kundërshtim me nenin 148 të Kushtetutës.

2. Lidhur me pretendimin e papajtueshmërisë me nenin 135 të Kushtetutës

Gjykata Kushtetuese konstaton gjithashtu, se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda është shprehur se pushimi i çështjes penale përbën dhënie të drejtësisë, e cila si funksion gjyqësor nuk mund të ushtrohet nga prokurori. Duke u shprehur në këtë mënyrë, pala kërkuese, në esencë, ka vënë në dyshim pajtueshmërinë e dispozitave të kundërshtuara edhe me nenin 135 të Kushtetutës. Në kuadrin e këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese trajtoi dhe nocionin e “dhënies (administrimit) së drejtësisë”, pra “të ushtrimit të pushtetit gjyqësor” në kuptimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese vëren se dispozita e nenit 135 të Kushtetutës, sipas të cilit, pushteti

gjyqësor ushtrohet nga [gjykatat] Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, në aspektin procedural penal, do të thotë se një person nuk mund të deklarohet fajtor për kryerjen e një veprë penale, e as mund t'i jepet një dënim penal, pa një vendim gjykate, të marrë në bazë të ligjit. Në aspektin kushtetues, administrimi i drejtësisë është funksion i gjykatave, çka përcakton vendin e kësaj dege të pushtetit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve. Asnjë institucion tjetër apo zyrtar i shtetit nuk lejohet ta kryejë këtë funksion.

Normat dhe parimet kushtetuese, mes të tjerash, e drejta e personit për një proces të rregullt ligjor, përbëjnë bazën e nocionit të dhënies së drejtësisë. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që është përgatitur më parë dhe dhënien e një vendimi përfundimtar mbi të. Gjatë gjykimit, një gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar këtë funksion, është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen në themel.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje, se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese nuk bashkohet me mendimin e shprehur se vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale përbën dhënie të drejtësisë. Kur ushtron ndjekjen penale prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë se, në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal, është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori. Veç kësaj, pushimi i akuzës ose i çështjes penale nga prokurori, në vetvete nuk barazohet me pafajësinë e të pandehurit.

Përfundimisht Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimmarrja e prokurorit në përfundim të fazës së hetimeve paraprake, si në rastin kur vendoset dërgimi i çështjes në gjykatë, ashtu dhe kur vendoset pushimi i çështjes penale, duke pasur parasysh natyrën e funksionit kushtetues të tij, është rezultat i shprehjes së vullnetit të këtij organi në ushtrim të ndjekjes penale.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se dispozitat e kundërshtuara nuk vijnë në kundërshtim me nenin 135 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 145/2 të Kushtetutës dhe të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi.

VENDIM

Nr.24, datë 12.11.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datë 17.1.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.57/11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Pavllo Kisi dhe Maria Kisi, përfaqësuar nga av.Flonia Tashko Boriçi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Vasilika Leka, përfaqësuar nga av.Dashamir Kore, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuësve që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuësit Pavllo Kisi dhe Maria Kisi janë fëmijët e Petro Kisit, vëllait të vetëm të trashëgimlënësës Marie Leka (Kisi), kurse subjekti i interesuar Vasiliqi (Vasilika) Leka është vajza nga martesë e dytë e bashkëshortit pasjetues të trashëgimlënësës, i quajtur Aristidh Leka. Trashëgimlënësja Maria Leka (Kisi) ka vdekur në 19.7.1944 dhe nuk ka lënë as fëmijë e as testament.

Gjykata Popullore e Rrethit Durrës, me vendimin nr.184, datë 11.3.1961, i lënë në fuqi me vendimin nr.114, datë 25.4.1961 të Gjykatës së Qarkut Durrës ka vendosur, që ati i kërkuësve, i quajtur Petro Kisi, të njihet trashëgimtar ligjor i motrës së tij, trashëgimlënësës Maria Leka (Kisi) në 4/8 pjesë të pasurisë së saj. Në përcaktimin e pjesës së tij trashëgimore gjykatat janë bazuar në dekretin nr.1892, datë 5.7.1954 “Mbi trashëgiminë” (i ndryshuar), sipas të cilit, në pasuritë e papjesëtuara trashëgimtarët e gjakut marrin gjysmën e trashëgimit.

Në gjykimin e padisë së ngritur nga kërkuësit me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara që të njohin të drejtën e tyre trashëgimore mbi vilën nr.27, të ndodhur në rrugën “Nikole Tupe” Tiranë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 kanë vendosur lënen në fuqi të vendimit nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pjesën që detyron subjektet e interesuara të njohin të drejtën trashëgimore të kërkuësve mbi këtë pronë. Për sa i përket të drejtës së pronësisë, gjykatat, duke iu referuar dhe duke interpretuar dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929, kanë pranuar në këtë çështje, se banesa është pronë vetëm e trashëgimlënësës Maria Leka (Kisi) dhe figuronte e tillë në dokumentet e zyrës së hipotekës. Për sa i përket të drejtës trashëgimore, gjykatat kanë përcaktuar se ligji në bazë të së cilit do të njihet e drejta trashëgimore e kërkuësve mbi pasurinë e trashëgimlënësës do të ishte po Kodi Civil i vitit 1929, sipas të cilit, në rast vdekje të bashkëshortit pa fëmijë, trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 e pasurisë së tij.

Mbi padinë e kërkuësve me objekt pjesëtimin e pasurisë, konkretisht të banesës së mësipërme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7573, datë 24.12.2004, ka pranuar se pronare e vetme e kësaj banese ishte trashëgimlënësja dhe ka vendosur lejimin e pjesëtimit mbi këtë pasuri duke u njohur kërkuësve 2/3 pjesë, ndërsa subjektit të interesuar 1/3 pjesë të saj. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.66, datë 28.4.2005 e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit duke i njohur kërkuësit bashkëpronarë në 2/6 pjesë, kurse subjektin e interesuar në 4/6 pjesë të banesës. Gjykata e apelit, në përcaktimin e së drejtës së pronësisë i është referuar dispozitave të Kodit Civil të vitit 1929 dhe, duke bërë një interpretim të ndryshëm nga interpretimi i mëparshëm i Kolegjeve të Bashkuara që njihin trashëgimlënësen si pronare të vetme, ka arritur në përfundimin se banesa ka qenë send në

bashkëpronësi ndërmjet trashëgimlënës dhe bashkëshortit të saj. Për sa i përket pjesës trashëgimore, gjykata e apelit i është referuar vendimit të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke zbatuar Kodin Civil të vitit 1929, sipas të cilit, trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo dekretin nr.1892, datë 5.7.1954 “Mbi trashëgiminë” (i ndryshuar), sipas të cilit, pjesët trashëgimore duhet të jetë të barabarta. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore.

Me gjithë kërkesën e Kolegjit Civil, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.4, datë 23.1.2007 nuk kanë pranuar të unifikojnë praktikën gjyqësore, por kanë zgjidhur çështjen konkrete duke iu dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga palët në gjykim. Në përfundim, Kolegjet e Bashkuara kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit duke u caktuar kërkuesve 2/6 pjesë në banesë, ndërsa subjektit të interesuar 4/6 pjesë. Ato arsyetojnë në vendim se për këtë përfundim janë bazuar në vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës që i përcakton si të barabarta pjesët trashëgimore të palëve, duke u bazuar në dekretin nr.1892, datë 5.7.1954 “Mbi trashëgiminë” (i ndryshuar).

Kërkuesit, bazuar në nenin 42 dhe 131, germa f të Kushtetutës, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke parashtruar këto pretendime:

- Vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, sepse bien në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.56, datë 23.9.2002. Në këtë vendim është pranuar se e drejta e pronësisë dhe pjesët trashëgimore do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929 dhe jo nga dekreti “Për trashëgiminë” i vitit 1954 (i ndryshuar). Si rrjedhojë, banesa është pronë vetëm e trashëgimlënës Maria Kisi.

Kërkuesit pretendojnë se me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë njohur pronarë në 2/3 pjesë të pronës objekt pjesëtimi, ndërsa me vendimin nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr.4, datë 23.1.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pjesa e tyre takuese është zvogëluar në 1/3 pjesë. Kërkuesit i referohen edhe vendimit nr.9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese ku pranohet cenimi i parimit të sigurisë juridike nga mohimi i një të drejte të fituar me një ligj të mëparshëm. Sipas tyre, ky parim duhet të shtrihet edhe në rastet e mohimit të një të drejte të fituar me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

- Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj. Sipas kërkuesve, me termin “gjykatë e krijuar me ligj” si element i procesit të rregullt, nuk duhet kuptuar vetëm gjykata në kuptimin e organizimit të përgjithshëm gjyqësor, por edhe gjykata si trup gjykues në gjykimin e një çështjeje. Sipas tyre, çështjes nuk duhet t’i ishte dhënë zgjidhje nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, përderisa Kolegjet e Bashkuara konkluduan se nuk do të njësonin praktikën gjyqësore. Sipas tyre ky qëndrim vjen në kundërshtim me nenin 141/2 të Kushtetutës dhe me vendimin nr.46, datë 28.6.1999 të Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti i interesuar parashtrroi këto prapësime:

- Çështja nuk i takon juridiksionit kushtetues, pasi nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së pretenduar si e shkelur, kërkesë kjo e nenit 131, germa f e Kushtetutës. Objekti i gjykimit është pjesëtimi i pasurisë, çka do të thotë që vendimi dhe gjykimi përfundimtar i padisë së pjesëtimit gjyqësor është vendimi dhe gjykimi që i jep fund regjimit të bashkëpronësisë. Vendimi mbi fazën e parë të këtij gjykimi nuk është përfundimtar, por vetëm i hap rrugë fazës së dytë, gjykimi e vendimi i së cilës është përfundimtar.

- Nuk ka cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi nuk është e vërtetë që vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i ka njohur kërkuesit bashkëtrashëgimtarë në 2/3 pjesë të banesës. As në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të gjykatës së rrethit dhe as në vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që e ka lënë atë pjesërisht në fuqi, nuk është përcaktuar madhësia e këtyre pjesëve ideale. Pjesët ndërmjet ndërgjyqësve janë përcaktuar me vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës, (vendim i formës së prerë). Në këtë të fundit, i quajtur Petro Kisi, i ati i kërkuesve, është njohur trashëgimtar i motrës së tij Marie Leka (Kisi) në gjysmën e pasurisë së saj. Referimi i kërkuesve në vendimin nr.9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese është krejt i pasaktë, pasi, në rastin në shqyrtim, nuk kërkohet

shfuqizimi si antikushtetues i një ligji, por i një vendimi gjyqësor.

- Nuk ka cenim të parimit të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë edhe kur gjykon në kolegje të thjeshta, edhe kur gjykon në Kolegje të Bashkuara, është gjykatë e krijuar me ligj. Vendimi i marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për dërgimin e kësaj çështjeje për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, është plotësisht i mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës, në nenin 481 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”. Edhe sikur të pranohet pretendimi i kërkuar se çështja duhet të shqyrtohet nga Kolegji Civil dhe jo nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kemi cenim të standardit, përkundrazi, është rritur garancia për palët në gjykim.

II

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e sheh me vend që, përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve të palëve rreth themelit të çështjes, të analizojë paraprakisht pretendimin e subjektit të interesuar, sipas të cilit, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për shqyrtimin e kërkesës, përderisa nuk ka mbaruar shqyrtimi i fazës së dytë të pjesëtimit në gjykatat e sistemit të zakonshëm dhe kërkuar nuk ka shtetur mjetet e ankimit në ato gjykata. Në lidhje me këtë konstatohet se vendimet që janë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese janë dhënë mbi bazën e padisë për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore. Gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, apo sendeve në bashkëpronësi, është një nga llojet e gjykimeve të posaçme që parashikohen nga Kodi i Procedurës Civile. Megjithatë gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore iniciohet nga një padi, e cila në thelb kërkon t’i japë fund regjimit të bashkëpronësisë, Kodi i Procedurës Civile parashikon se ky proces gjykimi realizohet në dy faza. Faza e parë e gjykimit ka për objekt shqyrtimi përcaktimin e rrethit të bashkëpronarëve, sendet që do të pjesëtohen dhe pjesët takuese të bashkëpronarëve mbi sendet objekt pjesëtimi, ndërsa me vendimin e fazës së dytë bëhet ndarja në natyrë e sendeve objekt pjesëtimi.

Gjykata, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e pjesëtimit gjyqësor dhe interpretimin që u kanë bërë këtyre dispozitave Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.628, datë 15.5.2000 konstaton se çështjet që zgjidhen në fazën e parë të këtij gjykimi nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi gjyqësor në fazën e dytë, fazë e cila fillon kur vendimi i fazës së parë ka marrë formë të prerë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se vendimi i fazës së parë të pjesëtimit është një vendim përfundimtar për problemet që ngrihen në Gjykatën Kushtetuese dhe si rrjedhojë nuk pranohet që kërkuar nuk i ka shtetur mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave në kuptim të nenit 131, germa f të Kushtetutës. Prandaj, çështja në shqyrtim është në juridiksionin e saj.

2. Në kërkesën e tyre drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkuar parashitjnë në thelb pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe atë të gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj.

2.1 Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Ndërsa, në vendimin nr.9, datë 26.2.2007 ajo ka zbërthyer më tej konceptin e besueshmërisë, duke theksuar se ajo “ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 42 të saj shpall parimin e moscenimit të lirisë së pronës dhe të të drejtave të njohura me Kushtetutë e me ligj pa një proces të rregullt ligjor, duke garantuar njëkohësisht të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive. Në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë.

Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizimit i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe

siguri kësaj marrëdhënie. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Prandaj, në vendimin nr.23, datë 8.6.2007 ajo ka pranuar se "...vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuarit ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim".

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila në çështjen *Kehaya and others v. Bulgaria* shprehet se "...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të së cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë, është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një vendim përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykatat, ajo duhet të vendoset një herë e përgjithmonë".

Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe në standardin e vendosur nga Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.

Gjykata Kushtetuese konstaton se padia mbi bazë të së cilës është dhënë vendimi i mëparshëm nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka pasur për objekt njohjen e së drejtës trashëgimore të kërkuarve mbi pasurinë e trashëgimlënësës dhe konkretisht, mbi vilën nr.27 të ndodhur në rrugën "Nikole Tupe", Tiranë. Për këtë arsye, pjesë e domosdoshme e këtij gjykimi ka qenë dhe hetimi e vërtetimi i faktit nëse prona, objekt gjykimi, ka qenë apo jo pronë tërësisht apo pjesërisht e trashëgimlënësës Maria Leka (Kisi). Gjithashtu, çështje e domosdoshme e këtij gjykimi ka qenë edhe përcaktimi i ligjit në bazë të të cilit do të njihej pjesa trashëgimore e kërkuarve mbi pasurinë e trashëgimlënësës. Në lidhje me faktin se në pronësi të kujt ka qenë banesa objekt mosmarrëveshje, kërkuarit kanë pretenduar se kjo pronë ka qenë në pronësi të trashëgimlënësës, ndërsa subjektet e interesuara kanë pretenduar se kjo pronë ka qenë në pronësi të bashkëshortit të saj Aristidh Leka, trashëgimlënësit të subjekteve të interesuara. Në fund të këtij gjykimi gjykatat, bazuar në Kodin Civil të vitit 1929, kanë pranuar përfundimisht faktin juridik se banesa objekt gjykimi, ka qenë tërësisht pronë e trashëgimlënësës Maria Leka (Kisi). Gjykatat kanë konkluduar gjithashtu se për caktimin e pjesëve trashëgimore ndërmjet ndërgjyqësve do të merrej për bazë Kodi Civil i vitit 1929, sipas të cilit trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo dekreti nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë" (i ndryshuar), sipas të cilit, si bashkëshorti, ashtu edhe trashëgimtarët e gjakut përfitojnë në pjesë të barabarta nga 1/2 pjesë secili.

Subjekti i interesuar, duke mos pranuar në Gjykatën Kushtetuese cenimin e parimit të sigurisë juridike, ka pretenduar se nuk është e vërtetë që vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i ka njohur kërkuarit bashkëtrashëgimtarë në 2/3 pjesë të pasurisë trashëgimore. Sipas tij, si në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të gjykatës së rrethit, ashtu dhe në vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk është përcaktuar madhësia e këtyre pjesëve ideale.

Në lidhje me këtë prapësim kërkuarit kanë pretenduar se pjesët takuese janë përcaktuar dhe dalin nga arsyetimi i vendimit të formës së prerë nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas kërkuarve, në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, arsyetimi i vendimit është detyrim kushtetues, ndërsa bazuar në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, pjesa arsyetuese e vendimit është një nga pjesët e vendimit gjyqësor civil, i cili së bashku me pjesët e tjera duhet të merret si një i tërë dhe i pandarë.

Për sa i përket këtij argumenti, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.33, datë 8.12.2005 është shprehur se "...vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në

përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara, të lidhura logjikisht dhe të respektojnë rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to.”

Bazuar në jurisprudencën kushtetuese Gjykata vëren se megjithëse në dispozitivin e vendimit nr.172, datë 22.1.1996 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk shprehet për pjesët takuese të trashëgimtarëve, përcaktimi konkret i tyre del jo vetëm nga pjesa arsyetuese e vendimit nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por edhe nga vetë referimi i gjykatës tek nenet 474 dhe 487 të Kodit Civil të vitit 1929 që duhen zbatuar në këtë rast. Gjykatat e mësipërme, në lidhje me të drejtën e pronësisë gjatë këtij gjykimi, duke interpretuar dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929, kanë pranuar faktin se trashëgimlënësja Maria Leka (Kisi) ka qenë pronare e vetme e banesës objekt gjykimi. Gjithashtu gjykatat, bazuar në dispozitat e lartpërmendura të Kodit Civil të vitit 1929, si dhe në faktin që Petro Kisi është trashëgimtar i vetëm në lidhje gjaku i trashëgimlënësës, arsyetojnë se këtij i takojnë 2/3 pjesë të banesës, ndërsa subjekteve të interesuara, si trashëgimtarë të bashkëshortit pasjetues, 1/3 pjesë e kësaj pasurie. Nga ky këndvështrim Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për pjesën që detyron subjektet e interesuara të njohin të drejtën trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e të ndjerës Maria Leka (Kisi) është i qartë.

Në lidhje me padinë, mbi bazën e së cilës janë dhënë vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se, këto vendime kanë të bëjnë me fazën e parë të gjykimit të pjesëtimit gjyqësor. Për këtë arsye, Gjykata e sheh të nevojshme që të theksojë edhe një herë çështjet që duhet të zgjidhë faza e parë e këtij gjykimi, të cilat në bazë të e nenit 370 të Kodit të Procedurës Civile janë hetimi dhe përcaktimi i së drejtës së bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre dhe sendet që do të pjesëtohen. Gjykata çmon se në një gjykim pjesëtimi, përcaktimi i rrethit të bashkëpronarëve është i lidhur në mënyrë të pandashme me përcaktimin e sendeve që do të pjesëtohen. Gjatë këtij gjykimi objekti i pjesëtimit është i njëjti send i paluajtshëm që ka qenë objekt gjykimi edhe në padinë për njohjen e së drejtës trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e Maria Lekës (Kisi). Në lidhje me rrethin e trashëgimtarëve bashkëpronarë, gjykatat e sistemit gjyqësor kanë konkluduar se banesa do të pjesëtohet vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, kërkuesve si trashëgimtarë të gjakut të trashëgimlënësës dhe subjektit të interesuar si trashëgimtare e bashkëshortit të trashëgimlënësës.

Gjykata e apelit, në vendimin nr.66, datë 28.4.2005, në përcaktimin e pjesës së pronësisë në banesë, në ndryshim nga sa ishte vërtetuar dhe njohur në gjykimet e vitit 2002 ka arritur në përfundimin, se banesa ka qenë send në bashkëpronësi ndërmjet trashëgimlënësës dhe bashkëshortit të saj, gjë që ka ndikuar në madhësinë e pjesës që do t’u takonte kërkuesve. Përsa i përket pjesës trashëgimore, gjykata e apelit i është referuar vendimit të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke pranuar indirekt zbatimin e Kodit Civil të vitit 1929, pra që trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo të dekretit nr.1892, datë 5.7.1954 “Mbi trashëgiminë” (i ndryshuar), sipas të cilit, pjesët trashëgimore duhet të jenë të barabarta. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Gjykata Kushtetuese, duke i krahasuar vendimet e mëparshme me vendimet objekt kundërshtimi vëren se gjykimi me objekt njohjen e së drejtës trashëgimore mbi banesën i vitit 2002 është një gjykim njohjeje dhe vërtetimi me qëllim që të krijohet apo të ndryshohet bashkëpronësia, ndërsa gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit është një gjykim gjithashtu njohës dhe vërtetues, por që ka qëllim t’i japë fund regjimit të bashkëpronësisë. Megjithatë, thelbi i mosmarrëveshjeve të vendosura me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara dhe me vendimin nr.4, datë 23.1.2007 të këtyre Kolegjeve është i njëjtë. Ai konsiston në përcaktimin e faktit se në pronësi të kujt ka qenë vila nr.27, ndodhur në rrugën “Nikolla Tupe” Tiranë dhe në bazë të kujt ligji material do të rregullohej trashëgimia ligjore e Maria Leka (Kisi). Në të dyja gjykimet palët, objekti dhe shkaku kanë qenë të njëjtë. Por, Gjykata Kushtetuese konstaton se zgjidhjet që gjykatat e sistemit gjyqësor u kanë dhënë, kanë qenë të ndryshme.

Gjatë gjykimit kushtetues, subjekti i interesuar ka pretenduar gjithashtu se pjesët ndërmjet

ndërgjyqësve janë përcaktuar që me vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës, sipas të cilit trashëgimtari i kërkuesve, Petro Kisi, është njohur trashëgimtar i Maria Leka (Kisit), në 4/8 pjesë të pasurisë së saj. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi nr.184, datë 11.3.1961 i Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës ka pasur për objekt përcaktimin e pjesëve ideale takuese të pasurisë trashëgimore të Marie Leka (Kisit) në përgjithësi, pa përcaktuar pasurinë konkrete të lënë trashëgim prej saj. Ky vendim nuk ka pasur për objekt verifikimin e pronësisë apo bashkëpronësisë të banesës, objekt mosmarrëveshje. Veç kësaj, ky fakt juridik nuk mund të bëhej pjesë e hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor edhe për arsye se në atë kohë kjo pasuri ishte e shtetëzuar.

Subjekti i interesuar pretendoi gjithashtu se vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim me vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës për sa i përket ligjit që duhet të zbatohet në përcaktimin e pjesëve të trashëgimisë ligjore. Kjo e fundit i ka njohur palët bashkëtrashëgimtarë në pjesë të barabarta në pasurinë trashëgimore duke u bazuar në dekretin “Për trashëgiminë” të vitit 1954 (i ndryshuar). Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi i lartpërmendur i Kolegjeve të Bashkuara nuk është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese nga subjekti i interesuar, dhe si rrjedhojë, duke ngelur i pacenuar, prevalon në pasojat që sjell.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimet objekt kërkese janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e nenit 6 të KEDNJ. Ato kanë cenuar parimin e sigurisë juridike duke i hequr efektet ligjore vendimit të formës së prerë nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

2.2. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se Gjykata e Lartë ka cenuar dhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, sepse çështjes nuk duhej t’i jepej zgjidhje nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por nga Kolegji Civil i saj.

Gjykata Kushtetuese konstaton se gjatë shqyrtimit të rekursit të kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi ta dërgojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të asaj gjykate për njësimin e praktikës gjyqësore. Këto të fundit, megjithëse vendosën të mos njësojnë praktikën gjyqësore, por vetëm të verifikojnë shkaqet e ngritura në rekurs dhe pretendimet e palëve, i dhanë vetë zgjidhje çështjes dhe nuk ia kthyen atë Kolegjit Civil.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar si cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor shqyrtimin e çështjes nga një gjykatë jo kompetente, por në çështjen në shqyrtim nuk u dhanë argumente të mjaftueshme kushtetuese për ta mbështetur këtë pretendim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori.

MENDIM PAKICE

Jemi kundër qëndrimit të shumicës. Mendoj se kërkesa e kërkuesve Pavllo e Maria Kisi, me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë

dhe nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë” është e pambështetur në nenet 131/f e 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat kanë prekur parimin e sigurisë juridike duke arsyetuar se me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, trashëgimtarët e Maria Lekës janë njohur bashkëpronarë në 2/3 pjesë të pasurisë së saj, ndërsa me vendimin nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me vendimin nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë u është mohuar kjo e drejtë e njohur më parë me vendimin e lartpërmendur.

Në të vërtetë, nga aktet bashkëngjitur rezulton, se me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk është vendosur njohja e kërkuesve si bashkëpronarë të një vile 2-katëshe, me sipërfaqe trualli prej 800 m², si pronë e Maria Kisit, në masën 2/3 pjesë e kësaj pasurie, por është vendosur prishja e vendimit nr.1550, datë 30.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe të vendimit nr.2767, datë 3.5.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pjesën që detyron të paditurit të njohin të drejtën trashëgimore të të paditurve mbi pasurinë e së ndjerës Marie Leka, si dhe rrëzimin e padisë dhe pushimin e gjykimit për pjesët e tjera të tyre, me arsyetimin se padia nuk mund të ngrihej.

Pra, me këtë vendim nuk është vendosur njohja e paditësve “Kisi” si pronarë të 2/3 pjesë të pasurisë në fjalë, por është lënë në fuqi vendimi nr.172, datë 22.1.1996 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vetëm për pjesën që ka vendosur njohjen e paditësve si trashëgimtarë mbi pasurinë e të ndjerës Maria Leka, pa përcaktuar pjesën e tyre në këtë bashkëpronësi.

Edhe në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, është vendosur pranimi i kërkesëpadisë dhe detyrimi i palës së paditur t’u njohë të drejtën trashëgimtarëve të Petro Kisit mbi pasurinë e Maria Lekës, pa përcaktuar se i njeh trashëgimtarë në 2/3 pjesë të kësaj pasurie. Sa u përket, në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor as në vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk është përcaktuar konkretisht sa është madhësia e këtyre pjesëve ideale.

Në këto rrethana, nuk kemi cenim të parimit të sigurisë juridike, sepse nuk kemi dy vendime gjyqësore që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme të njëjtës çështje. Parimi i sigurisë nënkupton detyrën e shtetit për të siguruar besim dhe qëndrueshmëri të rregullimeve ligjore për të mbrojtur të drejtat e fituara, si dhe respektimin e interesave dhe pritshmërive të ligjshme. Qëllimi i këtij parimi është të garantojë besimin e personave tek shteti.

Nga analiza e këtij parimi mund të nënvizohen 2 aspekte. Së pari: Rëndësia e parimit të sigurisë juridike presupozon disa kërkesa të detyrueshme për rregullimin ligjor në vetete. Ky rregullim duhet të jetë i qartë dhe harmonik, normat ligjore duhet të jenë të formuluar saktë. Aktet ligjore të nivelit më të ulët nuk duhet të konfliktohen me aktet e një niveli më të lartë, dhe aq më pak me Kushtetutën. Aktet normative duhet të shpallen sipas procedurës së përcaktuar dhe të gjitha entitetet, në raporte të ligjshme mes tyre, duhet të kenë një mundësi për t’u familjarizuar me to. Së dyti: Parimi i sigurisë juridike përfshin gjithashtu disa kërkesa në lidhje me vlefshmërinë e rregullimeve ligjore. Sipas këtij parimi, rregullimi ligjor mund të ndryshohet vetëm në përputhje me parimet dhe normat e Kushtetutës, duke siguruar vazhdimësinë e jurisprudencës.

Parimi i sigurisë juridike duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet e autoritetit shtetëror dhe mbi të gjitha nga Kuvendi, që nxjerr ligjet. Është rëndësi thelbësore që ligjvënësi, ndërsa rregullon zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë, të ndjekë këtë parim, me qëllim që situata ligjore në të cilën ndodhet një person të mos përkeqësohet pa arsye, madje të mos mohohen të drejtat e fituara, interesat apo pritshmëritë e ligjshme.

Parimi i sigurisë juridike gjithashtu presupozon, se në rastet kur për shkak të veprimeve të institucioneve, të autoritetit shtetëror të drejtat e personit janë cenuar, personit duhet t’i garantohet një mbrojtje ligjore efektive e këtyre të drejtave. Kushte të nevojshme të kësaj mbrojtjeje janë dhe pavarësia dhe paanësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave, të cilat janë të rëndësishme në sigurimin e sigurisë juridike për çdo anëtar të shoqërisë.

Parimi i sigurisë juridike është trajtuar dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, në vendimin nr.34, datë 20.12.2005 ku thuhet, se një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është dhe ai i sigurisë juridike, i cili ndër të tjera ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të

përcaktuara dhe të kuptueshme. Sigurisht që ato nuk mund të parashikojnë çdo rast që mund dhe duhet të lindë nga njohja dhe zbatimi i tyre në praktikë. Prandaj, në radhë të parë është detyrë e gjykatave apo e organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por, që të realizohet një gjë e tillë, ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt. Prandaj, duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat e parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi, ose dispozita të veçanta të tij.

Duke u shkëputur nga kjo trajtesë konstatoj se shumica nuk ka vlerësuar faktet, se Gjykata Popullore e Rrethit Durrës, me vendimin nr.172, datë 22.1.1961 ka vendosur njohjen e paditësit Petro Kisi si trashëgimtar në 4/8 pjesë të pasurisë së trashëgimlënës, motrës së tij Maria Leka, që ka vdekur në Tiranë më 18 korrik 1944. Ky vendim është gjykuar në shkallë të dytë dhe nga Gjykata e Qarkut Durrës, që me vendimin nr.114, datë 25.4.1961 ka vendosur lënien e tij në fuqi.

Veç këtij fakti, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin e tyre nr.4, datë 23.1.2007 e kanë marrë në përputhje me zgjidhjen që i ka dhënë kësaj çështjeje vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.184, datë 11.3.1961 i Gjykatës Popullore Durrës, që kishte fuqi detyruese konform nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

Për këtë arsye, në vendimin objekt shqyrtimi është trajtuar problemi i zbatimit të ligjit material dhe është pranuar se duhej zbatuar ligji i kohës, përfundim ky i bazuar në vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore Durrës. Sipas vendimit të lartpërmendur, që është lënë në fuqi me vendimin nr.114, datë 25.4.1961 të Gjykatës së Qarkut Durrës, është përcaktuar se pavarësisht se trashëgimlënësja M. Leka ka vdekur në kohën kur ligji i aplikueshëm është Kodi Civil i vitit 1929, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të mëvonshëm, rrethi i trashëgimtarëve nuk do të përcaktohet me ligjin e çeljes së trashëgimisë, por me ligjin që është në fuqi. Sipas nenit 62, të ndryshuar me nenin 27 të ligjit nr.3169, datë 26.10.1960, që ka ndryshuar dekretin mbi trashëgiminë, të vitit 1954, ky dekret zbatohet dhe për trashëgimitë që janë çelur para hyrjes së tij në fuqi. Ky problem, i parë në këtë këndvështrim, rezulton se problemi që diskutohet ka të bëjë me zbatimin e ligjit material, gjë që nuk është i lidhur direkt me standardet e procesit të rregullt ligjor për të cilat bën fjalë neni 131/f i Kushtetutës.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Xhezair Zaganjori.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.11.2008
Doli nga shtypi më 26.11.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Tiranë, 2008

Çmimi 43 lekë